



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA /
AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI

INFORMATIV

2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER/ URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA/
AGENCY OF GENDER EQUALITY

BULETINI INFORMATIV

2019

Editorial :

Edi Gusia Kryeshefe Ekzekutive, Agjencia për Barazi Gjinore, Zyra e Kryeministrit

Blerinda Idrizi, Udhëheqëse e Projektit NIRAS & CPM International- Projekti i Financuar nga SIDA

PËRMBAJTJA:**INICIATIVAT E AGJENCISË PËR BARAZI GJINORE.....12**

<i>Prezantohet udhëzuesi metodologjik "Parandalimi i Stereotipeve Gjinorë dhe Promovimi i Barazisë Gjinore në Tekstet dhe Materialet Shkollore"</i>	12
<i>ABGJ ka mbajtur trajnim me Zyrtar nga Zyrat e Informimit Publik në Institucionet e RKS si dhe me kompanitë e marketingut në sektorin privat</i>	14
<i>Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur sesion orientues për stafin e Universitetit të Prishtinës</i>	16
<i>ABGJ ka organizuar punëtori për përgatitjen e planit vjetor të punës për Zyrtar/e për Barazi Gjinore, në nivel ministrior dhe komunal</i>	17
<i>Agjencia për Barazi Gjinore ka mirëpritur në takim përfaqësues të Delegacionit të Ukrainës</i>	20
o <i>Takimi i delegacionit me ish Komisionin për Të drejta të njeriut, Barazi Gjinore, Persona të pagjetur dhe Peticione të Kuvendit të Kosovës</i>	21
o <i>Takimi i delegacionit me Komisionin për Verifikimin e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës</i>	22
o <i>Takimi i delegacionit me organizatën Un Women</i>	22
o <i>Takimi i delegacionit me qendrat e Medica Kosova dhe Medica Gjakova, në Gjakovë</i>	23
o <i>Takimi i delegacionit me Ambasaden Angleze</i>	24
<i>ABGJ ka mbajtur takime të përbashkëta me Agjencinë e Statistikave të Kosovës</i>	24
<i>ABGJ ka mbajtur trajnimin për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor</i>	25
<i>Vazhdon masa afirmative për Regjistrimin e Pronës pa Pages në Emër të dy Bashkëshortëve</i>	27
<i>ABGJ mirëpriti një Delegacion nga Këshilli i Republikës së Irakut</i>	28
<i>ABGJ priti në takim përfaqësues të Organizatës -Të drejtat e grave</i>	29
<i>ABGJ ka pritur në takim përfaqësues të Komisionit Evropian në Kosovë si dhe përfaqësues nga Komisioni Evropian në Strasburg</i>	29

**AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË PËR MBROJTJE
NGA DHUNA NË FAMILJE.....31**

<i>ABGJ ka vazhduar trajnimet për zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit</i>	31
<i>ABGJ ka publikuar raportin e Vlerësimit të nivelit të zbatimit të PSV</i>	32
<i>ABGJ ka mbështetur iniciativën për Amendamentimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje</i>	33
<i>ABGJ ka mbajtur trajnim me anëtarët e Shoqatës së Grave të Shërbimit Korrektues në Kosovë</i>	34
<i>ABGJ në bashkëpunim me Un- Women ka mbajtur punëtori për Shoqatën e Grave në SHKK</i>	34
<i>ABGJ ka mbështetur Komisionin Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës</i>	35

AKTIVITETE AVOKUESE.....36

<i>Shënohet 25 Nëntori Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas</i>	36
<i>Shënohet Dita Ndërkombëtare e Grave me thirrjen për më shumë vajza në shkencë dhe teknologji</i>	36
<i>Videospotete e realizuara nga Agjencia për Barazi Gjinore</i>	44
<i>Përkrahja e organizatave joqeveritare që promovojnë barazinë gjinore</i>	48
<i>Komunikatat për media</i>	49

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE.....51

<i>Përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore vizituan Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj</i>	51
<i>Përfaqësuesit e ABGJ prezantuan në Konferencë me temë Fuqizimi Ekonomik i Grave, Roli dhe Ndikimi i tyre në Komunitet</i>	53
<i>Përfaqësuesit e ABGJ prezantuan në Konferencën me temë "Procesi i njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës: Progresi dhe sfidat</i>	53
<i>Rrjeti i Grave në Shkencë dhe Arsim të Lartë në mbështetje të ABGJ kanë mbajtur punëtori njëditorë për planifikimin e aktiviteteve për vitin 2020</i>	54
<i>U mbajtur tryeza e diskutimit - Përfaqësimi gjinor në nivel lokal dy vjet pas zgjedhjeve lokale</i>	55
<i>ABGJ ka prezantuar në tryezën me Temë "Integrimi Gjinor në Nivel Lokal"</i>	56
<i>Përfaqësuesit e ABGJ-së morën pjesë në Konferencën "Le të kthejmë fuqinë për më shumë barazi gjinore" e cila u mbajtur në Bruksel</i>	57
<i>Përfaqësuesit e ABGJ kanë marrë pjesë në Konferencën për Indeksin e Barazisë Gjinore 2019, mbajtur në Bruksel</i>	58

ABGJ mori pjesë në takimin konsultativ rajonal ndërqeveritar për rishikim e platformës së Pekinit (B + 25) mbajtur në Shkup.....	59
Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ Edi Gusia, prezantoi në Forumin Rajonal për Konventën e Stambollit, në Tiranë.....	59
ABGJ mori pjesë në forumin dy ditorë, ku u diskua mbi përfundimin e përzgjedhjes së seksit të njëanshëm gjinor, mbajtur në Stamboll.....	60
ABGJ ka marr pjesë në takimin e nëntë, të shteteve anëtare të para anëtarësimit, mbajtur në Turqi.....	61
Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ Edi Gusia, mori pjesë në konferencën me temë “Ne nuk jemi armë të luftës”, të mbajtur në Luksemburg.....	62
AKVITITETE E ZYRTAREVE PËR BARAZI GJINOR NË MINISTRI DHE KOMUNA.....	63



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT/ OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA /
AGENCY FOR GENDER EQUALITY

Të nderuar/a bashkëpunëtor/e,

Me shumë kënaqësi Agjencia për Barazi Gjinore-Zyra e Kryeministrit shpalos para jush Buletinin Informativ të vitit 2019, ku prezantojmë iniciativat e realizuara në zbatim të Ligjit për Barazi Gjinore, dhe kornizës ligjore në tërësi që garanton barazinë gjinore në Republikën e Kosovës. Ky buletin paraqet aktivitetet e ABGJ-së, iniciativat e përbashkëta me mekanizmat gjinorë, institucionet e tjera, shoqërinë civile dhe partnerët tanë ndërkombëtarë .

Në zbatim të obligimit të paraparë me Ligjin për Barazi Gjinore , në gusht të 2019 ABGJ prezantoi për diskutim publik draftin final të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024. Procesi i hartimit të PKBGJ paraqet një model të veçantë, ku i tërë procesi i hartimit të këtij dokumenti strategjik është realizuar me metodologji moderne të miratuar nga këshilli drejtues, bazuar në proces gjithëpërfshirës dhe i paraprirë nga analiza sektoriale e ndërsektoriale. Për hartimin e këtij dokumenti u organizuan 11 punëtori dy ditore me grupe punuese, ku morën pjesë afro 370-të pjesëmarrës, afër 40-të institucione, Organizata jo qeveritare , organizata donatore, partnerë vendore dhe ndërkombëtare, morën pjesë në grupe punuese dhe ofruan komente në dokumentin e prezantuar për diskutim publik. Programi ka tre shtylla : a) Fuqizimi ekonomik dhe mirëqenia sociale b) Zhvillimi njerëzor, rolet dhe marrëdhëniet gjinore, c) Të drejtat e grave, qasja në drejtësi dhe siguri. Programi përfshin qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm që kanë të bëjnë me gjininë dhe janë integruar 40 indikatorët gjinorë të SDG-ve në objektivat dhe aktivitetet e programit të propozuar.



Gjatë vitit 2019 ABGJ ka arritur të prezantojë dhe të vërë në shfrytëzim nga administrata publike e Kosovës, institucionet publike, sektori i arsimit dhe publiku i gjerë, manuale, udhëzues dhe instrumente të profilizuara, të cilat lehtësojnë zbatimin e kornizave ligjore si në rastin e Ligjit për Barazi Gjinore duke ofruar ekspertize adekuatë në zbatimin praktik.

Gjatë vitit 2019 kemi publikuar udhëzuesin metodologjik *“Parandalimi i Stereotipeve Gjinorë dhe Promovimi i Barazisë Gjinore në Tekstet dhe Materialet Shkollore”* i cili udhëzon se si të integrohet perspektiva gjinore në tekstet dhe materialet shkollore, me qëllim të përgatitjes së teksteve të reja shkollore që ofrojnë modele të balancuara gjinore, më shumë hapësirë për autorët gra, dhe mbi të gjitha edukojnë brezat e ri me koncepte progresive të cilat lehtësojnë transformimin e shoqërisë në frymën e pjesëmarrjes së barabartë që nga moshat më të reja.

Një manual tjetër i prezantuar para institucioneve është *“Manuali për zbatimin e Vlerësimit të Ndikimit Gjinorë”* si instrument zbatues i “Strategjisë për Rregullim më të Mirë”, i cili do të ndihmojë institucionet por edhe shoqërinë në përgjithësi të vlerësojnë ndikimin gjinore në të gjitha iniciativat legislative por edhe politika të reja publike, mbi ndikimin që ato propozime të reja mund të kenë mbi jetën e burrave dhe grave në aspektin social, qasjes në burime dhe mundësi në përgjithësi. Veprimet tona institucionale përmes vlerësimit të ndikimit gjinore dëshmojnë pabarazitë përmes hulumtimit kualitativ të situatës dhe njëkohësisht hapin mundësitë që të ndërmarrim veprime adekuatë sipas nevojave të qytetareve gra dhe bura ne RKS. Gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2019 janë mbajtur pesë (5) trajnime dy ditore për anëtarët e 20-të grupeve punuese në ministri të angazhuar në hartimin e 20-të koncept dokumenteve ku trajnuan rreth 130 pjesëmarrës dhe 6-të sesione orientuese dhe 267 pjesëmarrës.

Është vazhduar me ngritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve për rastet e dhunës në familje. Zyrtarët e informimit publik në ministri janë trajnuar nga ekspert ndërkombëtarë mbi teknikat e prezantimit adekuat në frymën e legjislacionit të garanton barazinë gjinore.

Agjencia për Barazi Gjinore ka arritur të prezantojë Republikën e Kosovës në ngjarje të nivelit ndërkombëtarë në fushën e barazisë gjinore në përgjithësi dhe të drejtave gjinore në veçanti në takimet e: Fondi Monetar Ndërkombëtar në “Joint Viena Institut- Buxheti Gjinorë praktikë”; Dhuna seksuale në Konflikt, qasja në drejtësi për të mbijetuarit/at dhe sjellja para përgjegjësisë përgjegjësit –Wilton Park MB; “Promovimi dhe Implementimi i Konventës së Stambollit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi” me ftesë të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA); Në konferencën e organizuar nga Lartmadhëria Dukësia e Luksemburgut Maria Tereza, dhe në partneritet me Fondacionin Dr. Denis Mukwege “Ne nuk jemi armë të Luftës”.

ABGJ ishte nikoqire e vizitës së delegacionit të Ukrainës dhe Fondacionit të Dr. Denis Mukwege, gjatë qëndrimit të tyre 3 ditore në RKS me qëllim të njohjes së ekspertizës institucionale dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile në trajtimin e rasteve të mbijetuara të dhunës seksuale në Kosovë, ku

QRK paraqet në nivel global një model unik të mbështetjes së të mbijetuarave të dhunës seksuale.

Për të adresuar pozita e pafavorshme ekonomike të grave të Kosovës dhe mungesën e qasjes në pronë, që si rrjedhojë pengon avancimin e pozitës së tyre ekonomike dhe ushtrimit të drejtës së njeriut për qasje, zotërim dhe gëzim të pronës private ABGJ në bashkëpunim me Agjencinë Kadas-trale ka vazhduar masën afirmative edhe për një vit Prill 2019- Prill 2020, ku gjatë vitit 2019, 2110 çifte regjistruan pronën në emër të të dy bashkëshortëve .

ABGJ në realizmin e të gjitha këtyre objektivave të punës, pati mbështetjen e jashtëzakonshme të Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtarë- Sida, dhe me këtë rast falënderojmë Qeverinë Suedeze për ndihmën e pa kursyer përmes grantit të drejtpërdrejtë për ABGJ!

Kjo asistencë ishte një asistencë e cila ka sjelle punën e Agjencisë dhe çështjet gjinore në tërësi në qendrën e dialogut dhe të platformës së ndihmës në zhvillim dhe diplomacisë midis dy vendeve . Ky është një kontribut për avancimin e çështjeve gjinore në Kosovës në reflektim të plotë me misionin e Qeverisë Suedeze dhe Sidës të cilët i shohin çështjet gjinore të pa ndara nga progresi i qëndrueshëm dhe procesi i paqes duke i dhënë kështu një dimensionalitet të ri dhe frymëmarrje më të gjerë bashkëpunimit mes dy vendeve por edhe si model i mbështetjes institucionale të Qeverisë së Kosovës në çështje gjinore . Kontributi i Ambasadores- Shkëlqesisë së saj Karin Hernmarck Ahliny: ka qenë definues i këtij dialogu dhe një qasjeje pro aktive çka do të dëshironim ta shihnim në vazhdim në vitet e tjera në bashkëpunim edhe me donatorët e tjerë për një front të përbashkët në avancimin e çështjeve gjinore.

Po ashtu, kjo mbështetje u zbatua edhe përmes projektit të asistencës teknike të zbatuar nga Konzorciumi NIRAS – CPM International, projekti i udhëhequr nga znj. Blerinda Idrizi e cila me ekspertizën e saj profesionale dhe angazhimin e pa kursyer ndihmoi agjencinë në rrugëtimin e saj të përmbylljes së një cikli aktiviteteve që sjellin risi jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon në hartimin, vlerësimin dhe zbatimin e politikave publike dhe integritet gjinorë. Falënderojmë znj. Idrizi për kontributin, bashkëpunimin dhe mentorimin e shkëlqyer jo vetëm të stafit të ABGJ dhe mekanizmave gjinorë, por edhe të institucioneve relevante që bashkëpunuan me ABGJ-në.

Agjencia mbetet e përkushtuar të punoj për krijimin e një shoqërie ku gratë dhe burrat mund të shprehin dhe përfitojnë nga potenciali i tyre intelektual dhe profesional.

Falënderojmë partnerët dhe bashkëpunëtorët tonë në bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë 2019.

Faleminderit,

Edi Gusia,

Kryeshefe Ekzekutive

Agjencia për Barazi Gjinore

Zyra e Kryeministrit

BUXHETIMI I PËRGJEGJSHËM GJINOR - DISA SHËNIME TË RËNDËSISHME PËR T'U MBAJTUR NË MEND NË KËRKIM TË ZBATIMIT TË TIJ

Në vitin 1984, Australia prezantoi iniciativën e parë të buxhetimit gjinor. Përvoja australiane ishte e dukshme sepse rriti ndërgjegjësimin mbi buxhetet si instrumente të promovimit të barazisë gjinore dhe përcaktoi paradigmat e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, të ndjekura më vonë nga vendet e tjera. Megjithatë e paplotë në ditët e saj të para, kjo paradigmë shkencore bashkoi koncepte, praktika dhe teori të huazuara nga kornizat feministe, të politikës publike dhe ato ekonomike. Një nga postulatet domethënës që doli nga ditët e hershme të praktikave të BPGJ-së, ishte se buxhetet e shtetit nuk janë neutral në aspektin gjinor. Ato ndikojnë në mënyrë të ndryshme tek gratë dhe burrat, duke pasqyruar shpërndarjen e pabarabartë të pushtetit brenda shoqërisë si pabarazi ekonomike, kushte të ndryshme të jetesës dhe role shoqërore të atribuara. Të metat e paradigmes australiane të BPGJ-së nuk i ndaluan vendet e tjera që ndoqën hapat australiane për të përmirësuar, kontekstualizuar, modifikuar dhe prezantuar mjete dhe sisteme, aktorë dhe procese në paradigmen fillestare të BPGJ-së. Të gjithë këta elementë kanë kontribuar në tre dekadat e fundit në pasurimin e paradigmes së buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Ata u kanë ofruar politikë-bërësve, aktivistëve të barazisë gjinore, dhe studiuesve mundësi për të thelluar të kuptuarin e tyre të ndërlikimeve që kanë të bëjnë me aplikimin e BPGJ-së. Për më tepër, përmes praktikës së BPGJ-së, praktikuesit dhe teoricienët e BPGJ-së kanë qenë në gjendje të përsosin mjetet e BPGJ-së, të zgjerojnë zbatimin e saj në fusha që

më parë nuk ishin shqyrtuar dhe të testojnë idetë e tyre përmes një game të gjerë të iniciativave.



Deri më sot, shumë vende të botës kanë përqaftuar iniciativën e BPGJ-së. Disa prej tyre kanë qenë në gjendje të krijojnë BPGJ-në si platformën qendrore të alokimit të burimeve të tyre kombëtare dhe të zgjerojnë modelin në sektorin publik dhe privat; të tjerët kanë bërë të njëjtën gjë, por në nivele rajonale dhe provinciale. Ndërkohë, disa vende të tjera po eksperimentojnë me BPGJ-në në kërkim të asaj që i përshtatet më së miri kontekstit dhe rrethanave të vendit të tyre, me qëllimin përfundimtar të ndërtimit të modelit të tyre. Vendet e tjera janë akoma duke konsideruar idenë dhe janë në kërkim të pikave të sigurta të hyrjes. Përparimi i aplikimit të BPGJ-së është dhe mbetet i pabarabartë jo vetëm në nivel global, por edhe brenda një vendi. Pengesat, vonesat,

dhe zhvillimet dhe progresi asimetric në zbatimin e BPGJ-së shfaqen rregullisht dhe duket se, për momentin, janë fenomene të përditshme.

Ndërsa Kosova ka ndërmarrë hapa kritikë në vitet e fundit drejt zbatimit të BPGJ-së, disa mësimet të nxjerra nga përpjekjet e vendeve të tjera dhe parimet themelore të BPGJ-së në zbatimin e saj do të shërbejnë si shënime të rëndësishme për këtë proces të ndërlikuar. Ndërsa listat e këtyre shënimeve të rëndësishme janë relativisht të gjata, disa janë zgjedhur për tu shtjelluar më tej më poshtë, kryesisht sepse ato kanë rëndësi kontekstuale dhe në kohë me progresin aktual të BPGJ-së së Kosovës. Para së gjithash, buxheti i përgjegjshëm gjinor duhet të ruajë përmbajtjen e tij radikale si *strategji transformuese* drejt barazisë gjinore emancipuese dhe realizimit të të drejtave të grave. BPGJ nuk mund të jetë vetëm mjet i thjeshtë i shpërndarjes së burimeve "për të zgjidhur disa probleme të grave". Megjithatë, ai duhet të trajtojë njëkohësisht normat dhe vlerat shoqërore që prodhojnë marrëdhënie asimetrike të fuqisë ndërmjet burrave dhe grave. Në të njëjtën kohë, ata duhet të sigurojnë që të drejtat përmbushen në mënyrë progresive, dhe qasja dhe realizimi i të drejtave të afektojnë gjithnjë e më pak njerëz, deri në eliminim e pabarazive.

E dyta për këtë çështje dhe po aq të rëndësishme është ekzistenca e *vullnetit politik* për të mbështetur zbatimin e BPGJ-së. Për të mbështetur plotësisht zbatimin e BPGJ-së, *vullneti politik* do të duhet të mbështesë fort një politikë sistematike dhe për të zhvilluar plotësisht për integrimin e barazisë

gjinore të përfshirë në Kushtetutën e Kosovës, Ligjin e Kosovës për Barazinë Gjinore, kornizat e politikave të tjera vendore. Një vullnet i palëkundur politik drejt zbatimit të integritit të barazisë gjinore eliminon fragmentimin e zbatimit të agjendës së barazisë gjinore dhe kontribuon në përmbushjen e përgjegjësisë të bartësit të detyrës. Udhëheqja e duhur politike, në shumë raste, ka përshpejtuar zbatimin e BPGJ-së në vende të ndryshme dhe ka përmirësuar cilësinë dhe zbatimin sistematik të BPGJ-së, me rezultate të prekshme pozitive për qytetarët e saj.

Një politikë publike, për tu zbatuar me sukses, kërkon funksionalizimin e saj. Është proces që kërkon 'institucionalizimin' e vetë sistemit. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, si qasje politike në vetvete, përfshin institucionalizimin përmes tre elementëve thelbësorë: *strategjia, struktura dhe kultura*. Elementi i strategjisë detyron analizën dhe rishikimin e objektivave, procedurave, mjeteve, analizës së sistemeve të informacionit, të dhënave, regjistrave dhe teknikave të përdorura për gjenerimin e informacionit. Aktualisht, Kosova ka disa korniza solide të politikave gjinore, ato ligjore dhe zhvillimore, por jo të gjitha institucionet shtetërore kanë arritur institucionalizimin e plotë të tyre në fushat e tyre përkatëse institucionale me përgjegjësi. Për më tepër, është e domosdoshme një kornizë ligjore e BPGJ-së për të lehtësuar zbatimin e BPGJ-së. Sidoqoftë, modeli i propozuar duhet të pasqyrojë kontekstin e Kosovës, me fjalë të tjera, aspiratën e saj kombëtare dhe kornizën e saj të përparuar ligjore dhe institucionale, dhe nuk duhet të ndalet në ndërmarrjen e ndryshimeve të nevojshme të kornizave ekzistuese të politikave që mund të pengojnë zbatimin e BPGJ-së.

Në dy vitet e fundit, janë vendosur mjete dhe instrumente të reja dhe procedura të tilla si analiza gjinore dhe vlerësimi i ndikimit gjinor. Megjithatë, zbatimi i duhur dhe mbledhja e përfitimit të tyre nga zbatimi kanë rrugë të gjatë për të bërë. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore është thelbësor për performancën dhe aplikimin e tyre. Kërkohej kombinim i ekspertizës së jashtme të mëtijshme dhe edukimit formal të nëpunësve civilë për të arritur aplikimin cilësor të instrumenteve të tilla, dhe për të rritur më pas integritimin gjinor dhe cilësinë e BPGJ-së në politikat e prodhuara. Po aq thelbësore për aplikimin e suksesshëm të këtyre instrumenteve mbetet vëzhgimi rigoroz i kërkesave ligjore që kërkojnë aplikimin e analizës gjinore dhe vlerësimin e ndikimit gjinor të çdo dokumenti kornizë të politikave. Mungesa ose pajtueshmëria e dobët e këtyre kërkesave dhe mosaplikimi i duhur i analizave gjinore dhe instrumenteve të ndikimit në politikë-bërje siç ka treguar përvoja, ndikon rëndë në alokimin adekuat të buxheteve për burrat dhe gratë dhe arritja e qëllimit të transformimit të shoqërisë bëhet gjithnjë e më shumë një iluzion.

Megjithëse Kosova po bën përpjekje për të përmirësuar të dhënat e ndara sipas gjinisë, ende ka shumë për të bërë. Organizatat donatore përmes asistencës teknike dhe shoqëria civile kanë kontribuar në përmirësimin e cilësisë së të dhënave gjinore përmes përmirësimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit dhe metodologjive të mbledhjes së të dhënave. Megjithatë, këto janë të pamjaftueshme për të siguruar në mënyrë adekuate aplikimin e plotë dhe gjithëpërfshirës të BPGJ-së. Shumë institucione qendrore ekzekutive, komuna, gjyqësori dhe sundimi i ligjit, vuajnë nga mungesa e të dhënave ose të dhënave të ndara sipas gjinisë nuk kanë koherencën e kërkuar metodologjike. Pa sisteme të vendosura që mbledhin dhe prodhojnë të dhëna të besueshme, të standardizuara, administrative të ndara sipas gjinisë, të gjitha përpjekjet për të vendosur dhe zbatuar qasjet e BPGJ-së janë të kota. Mungesa e investimeve në konsolidimin e të dhënave administrative të ndara sipas gjinisë ndikon në cilësinë e politikave të përgjithshme kombëtare dhe avancimin e agjendës së barazisë gjinore të Kosovës dhe vë në dyshim arsyetimin e reformës së administratës publike në Kosovë. Nëse reforma e administratës publike nuk prodhon sisteme dhe procese më të mira të politikë-hartimit dhe më pas politika më të mira, çfarë qëllimi përmbush reforma multi-milionëshe e administratës publike?! Si e justifikon perspektivën e saj gjinore?!

Së fundi, në mbështetje të argumentit të institucionalizimit të BPGJ-së, elementet e *strukturës dhe kulturës* luajnë rol kryesor. Kosova tashmë ka vendosur shumë mekanizma dhe sisteme gjinore. Sidoqoftë, zbatimi i BPGJ-së do të përfshijë të gjitha strukturat organizative të administratës publike dhe institucioneve të drejtuara nga shteti. Rolet dhe përgjegjësitë e reja do t'u caktohen strukturave ekzistuese, dhe mund të shfaqen struktura të reja organizative. Këto ndryshime strukturore dhe i gjithë procesi i zbatimit të BPGJ-së do të kërkojnë udhëheqje elastike dhe të mirinformuar për të udhëhequr procesin e komplikuar. Përvoja e BPGJ-së e vendeve të tjera tregon se udhëheqja sigurohet më së miri kur makineritë gjinore dhe makineritë e financave të një vendi (d.m.th., ABGJ-ja dhe Ministria e Financave) janë drejtuesit kryesorë. Këta drejtues kryesorë, secili me ekspertizën e vet përkatëse, ofrojnë udhëzimet e nevojshme për administratën publike dhe entitetet shtetërore, për të zbatuar një BPGJ të integruar brenda roleve të tyre të atribuara. Në fazën fillestare të planifikimit të zbatimit të BPGJ-së, kjo do të kërkojë të kuptuarin e boshllëqeve gjinore dhe sesi masa të ndryshme të ndërmarra për këtë qëllim ndikojnë në adresimin e tyre dhe arritjen e barazisë gjinore. Kjo do të

kërkojë njohuri të thelluara të strukturave dhe mekanizmave themelorë, njohuri të plotë të praktikave të sistemit të menaxhimit të financave publike (MFP-së) të një vendi dhe identifikimin e reformave specifike për të adresuar reagimet që mund të priten nga aktore të ndryshëm.

Shumë duhet të ndryshojë brenda kulturës institucionale. Midis institucioneve dhe palëve të interesuara do të shfaqen forma të reja të komunikimit dhe koordinimit, për të ripërcaktuar vendimarrjen dhe arkitekturën ekzistuese të vendim-marrjes. Ndryshime të tilla duhet të mirëpritin dhe të kontribuojnë në lehtësimin e konflikteve të mundshme që mund të lindin gjatë zbatimit të BPGJ-së. Ndryshimet institucionale dhe organizative dhe ridimensionalizimi i vendim-marrjes nuk ndodhin kurrë pa konflikte. Mosmarrëveshjet më së miri është të shmangen ose minimizohen në këtë proces përmes hapjes, komunikimit të vazhdueshëm dhe koordinimit, besimit midis palëve të interesuara dhe konsideratës për fushat e tyre të autoritetit dhe përgjegjësisë, dhe llogaridhënies së bazuar në performancë. Ndarja e detyrave midis palëve të ndryshme të interesit dhe pjesëmarrja e tyre kuptimplotë duhet të jenë tiparet mbizotëruese të procesit të BPGJ-së. Megjithatë, ato do të japin rezultate të prekshme vetëm nëse merren parasysh fusha e ekspertizës dhe përgjegjësitë e secilës palë të interesuar. Cdo palë do të duhet të kuptojë më mirë sfidat me të cilat përballlet çdo palë e interesuar e përfshirë në proces dhe duhet të ndërtojë solidaritet dhe thellojnë bashkëpunimin midis të gjithë palëve të interesuara, dy elementë që janë shumë të nevojshëm në këtë proces sfidues.

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor është proces i gjatë që kërkon angazhim ditor nga të gjithë. Qasjet specifike sipas vendit ku zbatohet janë mënyra më e mirë për të zhvilluar BPGJ-në — nuk ka një qasje që i përshtatet të gjitha rasteve. Vendet përballen me probleme të ndryshme, që burojnë pjesërisht nga sisteme dhe institucione të ndryshme të MFP, gjë që kërkon larmi të qasjeve të BGPJ-së. Të mësuarit nga vendet e tjera është thelbësore, por mësimet duhet të përkthehen dhe të përshtaten me kontekstin e brendshëm. Procesi gjithashtu kërkon zhvillimin e ekspertizës, përsosjen e aftësive dhe ripërcaktimin e roleve nga të gjitha palët e përfshira: parlamenti, qeveritë, administrata publike, makineria gjinore, akademia, organizatat e shoqërisë civile, dhe donatorët. Ndryshimet dhe progresi më i mirë arrihen kur iniciohen dhe mbështeten nga brenda institucioneve. Marrë së bashku, ato do të maksimalizojnë integrimin gjinor dhe instrumentet dhe proceset e menaxhimit të financave publike që tashmë ekzistojnë në administratën publike të Kosovës. Përmirësimi i tyre dhe paraqitja e instrumenteve të reja do të përshtaten me qëllimin e rritjes së kapaciteteve njerëzore dhe institucionale dhe avancimin e zbatimit të BPGJ-së. Paraqitja e pafund e instrumenteve të reja të BPGJ-së dhe aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve të BPGJ-së të dizajnuara dobët, që zhvillohen në mungesë të koordinimit me ata që udhëheqin procesin duhet të shmangen. Ato kontribuojnë drejt “lodhjes gjinore”, minimizojnë bashkëpunimin midis aktorëve kryesorë dhe zvogëlojnë besueshmërinë profesionale për përkrahësit dhe mbështetësit e BGPJ-së.

Prezantimi dhe zbatimi gjithëpërfshirës i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor paraqesin si sfida ashtu edhe mundësitë në avancimin e përgjithshëm të agjendës së barazisë gjinore. Inovacionet duhet të përqafohen, ekspertiza shumëdimensionale e zhvillimit të vazhdueshëm duhet të perceptohet si shoqëruese e vazhdueshme për të gjithë, dështimet dhe suksesi duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, bashkëpunimi i ndershëm dhe i gjerë, konsensusi dhe qëllimet e përbashkëta midis të gjithë palëve të interesuara duhet të nxiten. Politikat e mira që parashihen për të gjithë mund të ndodhin vetëm përmes veprimeve të ndërmarra me vendosmëri dhe gjithëpërfshirëse, respektit dhe përgjegjësisë për diversitetin, njohjes progresive si mjet për përmirësimin e kushteve njerëzore dhe mbështetjen e njerëzimit që përballlet me rrethanat të panjohura më parë.

Blerinda Idri, Udhëheqëse e Projektit NIRAS & CPM International- Projekti i Financuar nga SIDA

INICIATIVAT E AGJENCISË PËR BARAZI GJINORE

Prezantohet udhëzuesi metodologjik “Parandalimi i Stereotipeve Gjinorë dhe Promovimi i Barazisë Gjinore në Tekstet dhe Materialet Shkollore”



Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë prezantuan udhëzuesin metodologjik “Parandalimi i Stereotipeve Gjinorë dhe Promovimi i Barazisë Gjinore në Tekstet dhe Materialet Shkollore”.

Ky udhëzues është në zbatim të drejtëdrejtë të kërkesave të Ligjit për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, respektivisht neni 2, i cili kërkon hartimin e teksteve shkollore dhe rishikimin e tyre nga perspektiva gjinore, si dhe eliminimin e stereotipeve gjinore në tekstet shkollore dhe materialet shkollore. Njëkohësisht, dokumenti i hartuar është zbatim konkret i Ligjit për Botimin e Teksteve Shkollore dhe Standerdeve për Tekstet Shkollore në Republikën e Kosovës, konkretisht në zbatim të drejtëpërdrejtë të Standardit të 11-të mbi integrimin e barazisë gjinore në tekstet dhe materialet shkollore dhe politikës së Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë “Korniza e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Kosovës”.

Takimi u hap nga Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ-së, znj. Edi Gusia, e cila mes të tjerave falenderoj Grupin Punues dhe Projektin për punën e bërë në hartimin e këtij udhëzuesi të domosdoshëm për zbatimin e perspektivës gjinore në tekstet dhe materialet shkollore, si kontribuese për transformime të fuqishme shoqërore dhe ndryshimin e avancimin e normave socio-kulturore që eliminojnë pabarazitë shoqërore dhe sigurojnë progres të qëndrueshëm.

Në vazhdim fjalën e mori Këshilltari Politik në Kabinetin e Ministrit në MASHT, z. Fatmir Bytyqi, i cili foli për rëndësinë që ka përfshirja e barazisë gjinore për zhvillimin e një shoqërie dhe theksoi se “dokumenti në fjalë prej vitit që vjen do të aplikohet dhe se çdo tekst shkollos që do të hartohet do të ketë për bazë këtë doracak në mënyrë që gjatë hartimit të teksteve të eliminohen stereotipet gjinore”.

Kurse, udhëheqësja e Projektit të menaxhuar nga NIRAS & CPM International dhe financuar nga Sida, znj. Blerinda Idrizi prezantoi përmbajtjen, synimet dhe përdoruesit kryesor të udhëzuesit metodologjik.

Ajo theksoi se pavarësisht që udhëzuesi metodologjik synon të jetë një mjet praktik, me një grup veprimesh sistematike, në ndihmë për shqyrtuesit e teksteve shkollore gjatë vlerësimit të drafteve të teksteve shkollore të paraqitura nga autorë të ndryshëm para publikimit të tyre, ai do t’u shërbejë njëkohësisht autorëve të teksteve, mësuesve në mësimdhënie, politikë-hartuesve dhe zbatuesve në sektorin e arsimit. Mandej edhe prindërve, si dhe shoqërisë civile në monitorimin e stereotipeve gjinore në tekste shkollore.

Udhëzuesi është konceptuar në tri kapituj kryesor, ku në pjesën e parë ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse, mbi rëndësinë e teksteve shkollore si një mjet për ndryshimet shoqërore dhe barazinë gjinore. Më tej, ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të koncepteve të barazisë gjinore dhe të të drejtave të njeriut si dhe të rëndësisë së tyre në arsimin e përgjithshëm për të gjitha përmbajtjet dhe për qëllimin e arsimit cilësor të cilin synon ta arrijë reforma në arsim.

Pjesa e dytë ofron një pasqyrë të koncepteve themelore gjinore dhe të rëndësisë së tyre në procesin e hartimit të teksteve shkollore, një vështrim mbi metodologjinë e përdorur për hartimin e këtij udhëzuesi metodologjik dhe përshkruan parimet kryesore se si të arrihet përfaqësimi egalitar gjinor në tekstet shkollore.

Së fundi, pjesa e tretë ofron mjete për vlerësimin e përfaqësimit gjinor në tekstet shkollore gjatë procesit të shqyrtimit, raportimin dhe vlerësimin përfundimtar mbi vlefshmërinë dhe cilësinë e tekstit shkollor.

Në aktivitet morrën pjesë punonjës zyrtarë të MASHT-it, ABGJ-së, ZBGJ-së, ata të ministrive të linjës dhe komunave, por edhe anëtarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë.

Të pranishmit vlerësuan meritat e dokumentit dhe sugjeruan vënien sa më parë në zbatim të udhëzuesit për t'u ardhur në ndihmë recenzentëve të përshtirë në shqyrtimin e draft-teksteve shkollore.

Hartimi i manualit u mbështet nga projekti për "Fuqizimin e Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave institucional për barazi gjinore" i financuar nga Sida, dhe realizuar përmes projektit – konzorciumit NIRAS- CPM Internacional.



ABGJ ka mbajtur trajnim me Zyrtarë nga Zyrat e Informimit Publik në Institucionet e RKS si dhe me kompanitë e marketingut në sektorin privat





Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur trajnim dy ditë radhazi me Zyrtarë nga Zyrat e Informimit Publik në të gjitha Ministrinë e RKS, si dhe me kompanitë e marketingut, konkretisht kompanitë që merren me reklama, videospote në sektorin privat.

Trajnimi ishte fokusuar në teknikat e prezantimit në frymën e legjislacionit që garanton barazinë gjinore, rritjen e njohurive për raportimin dhe prezantimin mediatik në formë të drejtë dhe të pa influencuar nga stereotipet gjinore. Artikulim të mesazheve relevante në frymën e këtij legjislacioni dhe promovimin e mundësive të barabarta për vajzat dhe djemtë, gratë dhe burrat në Kosovë.

Trajnimi është mbajtur nga eksperti ndërkombëtar i fushës së mediave dhe barazisë gjinore Dr. Massimiliano Fusari, përmes projektit të financuar nga Sida për ABGJ dhe i realizuar përmes Konzorciumit NIRAS-CPM International.



Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur sesion orientues për stafin e Universitetit të Prishtinës



Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur sesion orientues për stafin e Universitetit të Prishtinës, dhe studentë të Fakultetit Ekonomik për përfshirjen e perspektivës gjinore në proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies në fushën e ekonomisë.

Në këtë takim prezantuan Kryshefja Ekzekutive e ABGJ –së, Edi Gusia, Dekani i Fakultetit Ekonomik, But Dedaj, Blerinda Idrizi - Udhëheqëse e projektit NIRAS/CPM International, projekt i financuar nga SIDA, si dhe konsulentja Gisela Carrasco-Miró, e cila prezantoi mbi Integrimin e Perspektivës Gjinore në Studimet Ekonomike në Shkollimin e Lartë.

Ky sesion orientues ka rrjedhë nga marrëveshja e bashkëpunimit të nënshkruar nga ABGJ dhe UP.

Po ashtu, është rishikuar kurikula e re, në Fakultetin Ekonomik dhe është vendosur lënda e re “Ekonomiksi Gjinor”, si dhe janë blerë 5 tituj të librave të cilat do të përdoren si literaturë nga profesorët dhe studentët.

Procesi i vendosjes së marrëveshjes së bashkëpunimit, sigurimit të fondit librar, përkthimit të një teksti universitar, dhe ofrimit të ekspertizës ndërkombëtare për vendosjen e lëndës është financuar nga Ambasada Suedeze përmes ndihmës direkte financiare për Agjencinë, e zbatuar përmes projektit mbështetës Niras-CPM – International.

Titujt e librave janë: Joyce Jacobsen, 2007, The Economics of Gender 3rd Edition, Wiley-Blackwell,

Deborah M. Figart, Tonia L. Warnecke, D. M. Figart (Editor), T. L. Warnecke (Editor), 2015, Handbook of Research on Gender and Economic Life, Edward Elgar Publishing Ltd,

Mukesh Eswaran, 2014, Why Gender Matters in Economics, Princeton University Press,

Lourdes Beneria, Günseli Berik, and Maria Floro, 2015, Gender, Development and Globalization: Economics as if All People Mattered, 2nd edition, Routledge

Martha Gutierrez, 2003, Macro-Economics: Making Gender Matter; Concepts, Policies, and Institutional Change in Developing Countries, New York, Zed Books.

ABGJ mbajti punëtori për përgatitjen e planit vjetor të punës për Zyrtar/e për Barazi Gjinore në nivel ministror dhe komunal



ZBGJ niveli ministror



ZBGJ niveli komunal

Agjencia për Barazi Gjinore ka organizuar punëtori për përgatitjen e planit vjetor të integruar të punës për Zyrtar/e për Barazi Gjinore në nivel ministror dhe komunal, mbajtur në Tiranë, Shqipëri.

Punëtorja është financuar nga ABGJ dhe është mbajtur në kuader të zbatimit të planit të punës, Projekti “Fuqizimi i Agjencisë për Barazi Gjinore dhe mekanizmave institucional për barazi gjinore në Kosovë”, projekt i financuar nga Qeveria Suedeze – Sida, që drejtohet nga Konsorciumi Niras & CPM International.

Qëllimi i projektit është fuqizimi i kapaciteteve institucionale të ABGJ-së dhe i mekanizmave kombëtar të barazisë gjinore për të përmbushur mandatin e tyre në mënyrë efektive dhe efikase për integrimin e axhendës së barazisë gjinore në të gjitha kornizat e politikave dhe sistemeve të Kosovës.

Prandaj, trajnimi ka shtjelluar zbatimin e Udhëzuesit mbi Sistemin e Integruar të planifikimit vjetor për Mekanizmat Gjinor në Kosovë.

Ndryshe, Udhëzuesi jep një pasqyrë gjithëpërfshirëse të përgjegjësive dhe roleve pozicionuese të Zyrtarëve të Barazisë Gjinore, si dhe menaxherët dhe zyrtarët e tjerë që janë pjesë e institucioneve për barazi gjinore dhe subjektet tjera qendrore të financuara nga publiku.

Fokus i veçantë i kushtohet bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërinstitutional, si mjet për të arritur shpërndarjen efektive të detyrave dhe përgjegjësive.

Punëtorja për Zyrtaret për Barazi Gjinor në nivel ministror është mbajtur me datë 28-29 tetor, ndërsa me nivelin komunal 30-31 tetor 2019.

Nga niveli ministror kanë marrë pjesë 17 zyrtarë, të gjitha gra, ndërsa nga komunat 24 gjithsej dhe prej tyre 21 gra dhe 3 burra.



Agjencia për Barazi Gjinore ka mirëpritur në takim një delegacion nga Ukraina



Agjencia për Barazi Gjinore me datën 21 tetor 2019 ka mirëpritur në takim një Delegacion nga Ukraina, i cili ka qëndruar për një vizitë njëjavore në Kosovë.

Delegacionin nga Ukraina, u njoftuan nga Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ-së, Edi Gusia dhe nga Shefja e Legjislacionit, Leonora Selmani, lidhur me përvojën dhe modelin e Kosovës në shërbimin e viktimave të luftës të dhunës seksuale.

Qellimi i kësaj vizite studimore i Delegacionit nga Ukraina, i mbështetur nga Fondacioni Dr. Denis Mukwege, është që të mësohet nga institucionet dhe aktet e Kosovës, ato qeveritare dhe joqeveritare, mbi përvojën e tyre të deritanishme, sfidat dhe mësimet e marra nga trajtimi i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Kosova, është i vetmi vend në botë që aktualisht po implementon një model të skemës së dëmshpërblimeve për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës.

Fondacioni Dr. Denis Mukwege është një organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, i krijuar me qëllimin për t'i dhënë fund përdorimit të dhunës seksuale në konflikt.

Së bashku me këshilltarin e saj të veçantë, gjinekologun Kongolez dhe aktivistin për të drejtat e grave Dr. Denis Mukwege, fondacioni gjithashtu mbështet projekte për të ndihmuar të mbijetuarit në mbarë botën. Në nivelin global, Fondacioni Mukwege, përmes zyrave të tij në Hagë dhe Gjenevë, punon me qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare për të zbatuar normat dhe rregullat që ndalojnë dhunën seksuale. Fondacioni Mukwege është sekretariati për SEMA, Rrjeti Global i Viktimave dhe Të Mbijetuarve për t'i dhënë fund Dhunës Seksuale të Luftës.

Derisa në mbrëmje për nder të delegacionit të Ukrainës u organizua pritje nga ABGJ, ku ishin prezent përfaqësues të Korit Diplomantik në Kosovë, partner vendor dhe ndërkombëtar.

ABGJ gjatë qëndrimit të delegacionit në Kosovë ka koordinuar të gjitha takimet për t'u njohur me punën e institucioneve shtetërore të Kosovës, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar në mbështetje të viktimave të luftës seksuale në Kosovë.

Vizita e Delegacionit të aktivisteve nga Ukraina, përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe Mekwege Foundation, u realizua përmes mbështetjes së Ambasadës Suedeze – Sida dhe projektit të asistencës teknike për ABGJ – NIRAS-CPM Internacional.



Fjalimi i Ambasadores Suedeze në Kosovë, Karin Hernmarck Ahliny, në pritje të delegacionit të Ukrainës

Takimi i delegacionit me ish- Komisionin për Të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione të Kuvendit të Kosovës



Agjencia për Barazi Gjinore, ka vazhduar me mbajtjen e takimit me përfaqësues nga Delegacioni i Ukrainës dhe me ish- Komisionin për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione të Kuvendit të Kosovës.

Mysafirët paten mundësinë të njihen më afër me punën dhe mbështetjen që komisioni ka treguar për kategorinë e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Takimi i delegacionit me Komisionin për Verifikimin e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës



Delegacioni i Ukrainës pati takime me Komisionin për Verifikimin e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës, për t'u njoftuar me përvojën dhe modelin e Kosovës në trajtimin e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës i njoftoi të pranishmit me procesin në përgjithësi, progresin e arritur në trajtimin e kësaj kategorie, si dhe për sfidat të cilat e përcjellin këtë proces.

Takimi i delegacionit me organizatën Un Women



Në takim i priti Vlera Nushi, Drejtoreshë e Un Women ku u shkëmbyen përvojat lidhur me punën dhe mbështetjen që ofrohet për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe te adresimit në Institucione.

Takimi i delegacionit me qendrat e Medica Kosova dhe Medica Gjakova, në Gjakovë



Takimet vazhduan edhe në qendrat e Medica Kosova dhe Medica Gjakova, në Gjakovë. Delegacioni kishte mundësinë të njihej nga afër me punën dhe mbështetjen që këto dy organizata ofrojnë për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës.

Përfaqësueset e dy organizatave Znj Veprorë Shehu dhe Znj Mirlinda Sada, rrëfyn për procesin e trajtimit të mbijetuarve të dhunës seksuale, aktivitetin të cilin e zhvillojnë nder vite, duke u fokusuar në rolin e rëndësishëm që luan fuqizimi ekonomik përmes programeve të ndryshme si rrugë për tejkalimin e stigmes dhe rehabilitimin socio ekonomik.

Takimi i delegacionit me Ambasaden Angleze

Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur takim me përfaqësues të Ambasadës së Britanisë së Madhe, si dhe me delegacionin nga Ukraina, të cilët gjatë kësaj dite edhe përfunduan viziten nje javore në Kosovë.

ABGJ ka mbajtur takime të përbashkëta me Agjencinë e Statistikave të Kosovës

Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur dy takime me përfaqësues të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), nisur me inicimin e kalkulimit të Indeksit të Barazisë Gjinore në Kosovë.

Kjo iniciativë është vazhdimësi e bashkëpunimit ndërinstutucional në mes ABGJ-së dhe ASK-së, e cila ka filluar në janar të këtij viti dhe ka vazhduar me takimet të cilat janë mbajtur lidhur me dorëzimin e të dhënave dhe shkëmbimin e informacioneve mbi ecurinë e punës në përgjithësi në drejtim të realizimit të Indeksit të pjesërishëm të barazisë gjinore.

Takimet u financuan nga SIDA Suedeze-projekt për fuqizimin e mekanizmave instutucional për Barazi Gjinore.

ABGJ ka vazhduar me trajnimet për Vlerësimin e Ndikimit Gjinator

Agjencia për Barazi Gjimore gjatë vitit 2019 ka organizuar gjithsej pesë (5) trajnime lidhur me vlerësimin e ndikimit gjinator me fokus grupe, ku ishin të përfshirë të punësuar nëpër ministri, të cilët punojnë drejtëdrejt në hartimin e koncept dokumenteve.

Gjatë trajnimeve janë shtjelluar tema të cilat kanë të bëjnë me analizat gjimore, përshkrimi i qëllimeve të VNR-së, shfrytëzimi i analizave të bëra për rëndësinë gjimore, definimi i opsioneve, analiza e ndjeshme gjimore dhe peshimi i ndikimit gjinator. Mandej identifikimi dhe vlerësimi i ndikimit të ardhshëm (ndikimi ekonomik, shoqëror, mjedisor, ndersektorial dhe buxhetor.

Pjesëmarrës në trajnim kanë qenë gjithsej 94 persona, 62 gra 32 burra.

Gjatë trajnimeve janë diskutuar dhe shqyrtuar 14 koncept dokumente.

- Koncept dokumenti për prokurimin publik
- Koncept dokumenti për Regjistrimin e popullisë
- Koncept dokumenti për të drejtat dhe autorizimet dhe përgjegjësitë e profesionistëve shëndetësor
- Koncept dokumenti për Agjencinë e Regjistrimit civil
- Koncept dokumenti në fushën e punimeve nga metalet e çmuara
- Koncept dokumenti për vlerësimin strategjik mjedisor
- Koncept dokumenti për rregullimin e fushës së mbeturinave
- Koncept dokumenti për parkun kombëtar Bjeshkët e Nemuna
- Koncept dokumenti për Sëmundjet ngjitëse, nga Ministria e Shëndetësisë,
- Koncept dokumenti për Sistemimin e punëtorëve të huaj të punësuar në RKS
- Koncept dokumenti për Skemen e ndihmës sociale në Kosovë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Koncept dokumenti për Avancimin e legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
- Koncept dokumenti për të drejtën e autorit dhe të drejtën e përafërt si dhe
- Koncept dokumenti për Muzetë nga Ministria e Kulturës Rinis dhe Sportit.

Trajnimet janë mbajtur nga ekspertja ndërkombëtare Anamaria Golemac Powell, Irena Rozajac dhe Blerinda Idrizi, Udhëheqëse e projektit, konzorciumit NIRAS- CPM International.

Trajnimet u realizuan me mbështetjen financiare të SIDA-s.



Vazhdon masa afirmative për Regjistrimin e Pronës pa Pagesë në Emër të dy Bashkëshortëve



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS
KADASTARSKA AGENCIJA KOSOVA
KOSOVO CADASTRAL AGENCY

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY OF GENDER EQUALITY

Të nderuar Qytetarë dhe Qytetare të Republikës së Kosovës

PËRFITONI nga Udhëzimi administrativ (QRK) Nr. 02/2019 Masat e Veçanta për regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy bashkëshortëve

"Regjistroni PRONËN FALAS"

Në emër të dy bashkëshortëve në zyrën Kadastrale të Komunës

Afati për regjistrim: Prill 2019 - Prill 2020

Mbështetur nga SIDA



www.abgj.rks-gov.net

Me vendimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës nr.01/99 të datë 23.04.2019 është miratuar vazhdimi i masës afirmative për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve në afat një vjeçar, Prill 2019-Prill 2020 që të regjistrohet pa pagesë prona e tyre në gjithë teritorin e Republikës së Kosovës.

Që nga hyrja në fuqi në vitin 2016 deri në vitin 2019 kanë përfituar 5392 bashkëshort.

ABGJ me qëllim të njoftimit të opinionit për vazhdimin e kësaj mase afirmative ka realizuar disa poster të cilët janë shpërndarë në të gjitha komunat e RKS, billboarda si dhe një videospot televiziv i cili është transmetuar në RTK.

Po ashtu është publikuar edhe Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr. 02/2019 Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy bashkëshortëve.

ABGJ mirëpriti në takim Delegacionin nga Këshilli i Republikës së Irakut

Agjencia për Barazi Gjinore ka mirëpritur në takim një Delegacionin nga Këshilli i Republikës së Irakut – Parlamenti Irakian, i cili ka qëndruar për një vizitë në Kosovë nga data 11 -15 Dhjetor.

Përfaqësuesit nga Iraku, zhvilluan takim me Kryeshefen Ekzekutive të ABGJ, Edi Gusia, Shefen e Divizionit për Bashkëpunim, Shpresa Zariqi, si dhe Ud. Shefen për Raportim dhe Monitorim Znj. Adelina Kajtazi.

Të pranishmit u njoftuan me mandatin e ABGJ si dhe me përvojat dhe modelin e Kosovës, në njohjen dhe verifikimin e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë. Po ashtu, gjatë prezantimit u fol edhe për punën e Komisionit në shërbim të kësaj kategorie.

Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte që të mësohet nga institucionet e Kosovës, ato qeveritare dhe joqeveritare, mbi përvojën e tyre të deritanishme, sfidat dhe mësimet e marra nga trajtimi i viktimeve të dhunës seksuale gjatë luftës.

Kosova, është i vetmi vend në botë që aktualisht po implementon një model të skemës së dëmshpërblimeve për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës.

Vizita u organizua si pjesë e përpjekjeve të IOM-it për të përkrahur institucionet e Irakut në procesin e dizajnit dhe implementimit të Programit të kompensimit për të mbijetuarat e dhunës seksuale të kryera nga grupi terrorist ISIL gjatë konfliktit në Irak.

Parlamenti Irakian momentalisht po e shqyrton mundësinë e aprovimit të Draft Ligjit për përkrahjen e grave Yazidi.

ABGJ priti në takim përfaqësues të Organizatës - Të drejtat e grave



Një delegacioni i Organizatës Women's Rights/Të drejtat e grave/Zensko Pravo, ishte për vizitë në Agjencinë për Barazi Gjinore.

Delegacioni u prit nga Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ-së, Edi Gusia dhe Shefet e divizioneve të ABGJ-së.

Kjo vizitë ishte në vazhden e vizitave të planifikuara nga Organizata për të drejtat e grave, që po i zhvillon në kuadër të projektit Gratë për Barazi dhe Paqe në Komunitet Veriore të Kosovës.

Me këtë rast grupi multietnik i grave të cilat përfaqësojnë Organizatën - Të drejtat e grave, u njoftuan nga Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ-së, Edi Gusia me historikun, punën, aktivitetet, sukseset dhe sfidat që pritet të zhvillohen në të ardhmen gjatë realizimit të planit dhe aktiviteteve të ABGJ-së.

Në këtë takim u arrit dakordim që të vendoset një bashkëpunim në mes të ABGJ-së dhe kësaj Organizate.

ABGJ ka pritur në takim përfaqësues të Komisionit Evropian në Kosovë si dhe përfaqësues nga Komisioni Evropian në Strasburg

Agjencia për Barazi Gjinore ka mirëpritur në takim Znj. Isabelle Servoz-Gallucci, Shefe e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, dhe Znj. Larissa Kireeva nga Divizioni për Barazi Gjinore në Këshillin e Evropës në Strasburg.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi dhe prezantimi i ri i Këshillit të Evropës që do të ketë në fokus dhunën në baza gjinore dhe mënyrat e bashkëpunimit me institucionet e Republikës së Kosovës.

Në emër të ABGJ-së Kryeshefja Ekzekutive, Edi Gusia, i ka njoftuar mysafirët me mandatin e Agjencisë për Barazi Gjinore me përkushtimin dhe angazhimin e ABGJ-së, si hartuese e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Procedurave Standarde të Veprimit për trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje dhe Komentarit të Ligjit për Barazi Gjinore.

Në drejtim të parandalimit dhe luftimit të fenomenit të Dhunës në Baza Gjinore dhe Dhunës në Familje ABGJ gjatë vitit 2018 ka orientuar rreth 25% të buxhetit të saj në drejtim të zbatimit të Strate-

gjisë për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020, ku ABGJ ka përgjegjësinë e Zv.Koordinatorit Nacional për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020 .

Gjatë takimit ABGJ u zotua se do të përkrahë iniciativën e Këshillit të Evropës për asistencë në drejtim të ndihmës së institucioneve për ta avancuar qasjen në drejtësi të mbijetuarave të dhunës, financimit të qëndrueshëm të strehimoreve, sensibilizimit të pushtetit lokal për përgjegjësinë dhe zbatimin e kësaj strategjie.

Gjithashtu ABGJ vlerëson se fuqizimi ekonomik i të mbijetuarave duhet të konsiderohet si prioritet nga institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë, njëkohësisht trajtimi i dhunuësve duhet të jetë obligues derisa duhet asistuar në krijimin e programeve që trajtojnë dhunuesit.

ABGJ insiston në hapjen e një strehimoreje për burrat dhe djemtë, si dhe një strehimoreje të përbashkët në Mitrovicë .

Të pranishmit u dakorduan për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit në vazhdimësi gjatë fazës së zbatimit të projektit të Këshillit të Evropës.

AKTIVITETET NË ZBATIM TË STRATEGJISË PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE

ABGJ ka vazhduar trajnimet për zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit



Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit bazuar në planin e punës për vitin 2019 dhe prioritetet e parapara, si ngritja e kapaciteteve profesionale dhe me qëllim që të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë e nëpunësve civil, në bashkëpunim edhe me akteret institucional që merren me zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit në përputhje me kornizat ligjore ekzistuese, si dhe me vendimin nr: 069/2019 për emërimin e grupit punues ka përgatitur modulën e trajnimeve për Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen nga dhuna në Familje, me mbajtjen e një punëtorie dy ditore në Strug.

Ky modul është përdorur gjatë tërë kohës së mbajtjes së trajnimeve në 5 regjionet e Kosovës, Prishtinë, Gjilan, Mitrovicë, Prizren dhe Pejë dhe i cili ka shërbyer si metodologji e punës gjatë tërë kohës.

Në përgjithësi, trajnimi kishte për qëllim të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë e akterëve që merren me zbatimin e PSV, për t'i performuar përgjegjësitë e tyre ligjore drejt garantimit dhe avancimit të mbrojtjes nga dhuna në familjet e Kosovës në përputhje me kornizat ligjore ekzistuese dhe me qëllim të përmisimit të reagimit të shtetit ndaj rasteve të dhunës në familje.

Objektivat e këtij trajnimi janë të specifikuar si më poshtë:

- Definimi i dhunës në familje, sipas ligjeve vendore dhe nderkombetare si dhe rolet dhe përgjegjësitë e akterëve në mbrojtjen nga dhuna në familje
- Të kuptuarit e faktorëve që shkaktojnë dhunën dhe llojet e dhunës në familje si dhe trendet e fundit.
- Të njohin rëndësinë e përmbushjes të obligimeve akterët përgjegjës për trajtimin e dhunës në familje në ndërmarrjen e masave ligjore në zbatimin e procedurave të identifikimit, referimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe reintegrimit të viktimës së dhunës në familje.
- Të njohin rëndësinë e bashkërendimit dhe koordinimit të aktiviteteve ndërmjet akterëve institucional për reagimin ndaj rasteve të dhunës në familje.

- Njohja me pasojat që shkaktohen nga mosveprimi dhe neglizhenca e rasteve të dhunës në familje

Në këto sesione trajnuese morën pjesë Zyrtarët nga Zyra e Mbrojtësve të viktimave, Policia e Kosovës, Prokuroria Themelore, Gjykata, Punëtorët shëndetësor, punëtorët social dhe ata nga QPMS, përfaqësues të strehimoreve të cilët janë ftuar për pjesëmarrje nga ABGJ dhe vetë trajnerët / et, si përfaqësues të institucioneve të tyre.

Totali i pjesëmarrësve ishte 213, nga ta 131 gra dhe 82 burra.

ABGJ ka publikuar raportin e Vlerësimit të nivelit të zbatimit të PSV

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar Vlerësimin e nivelit të zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, me qëllim të ofrimit të informacioneve të nevojshme lidhur me zbatimin e PSV-ve nga institucionet relevante.

Vlerësimi i zbatimit gjithashtu identifikon edhe pikat kyçe të cilat duhet rishikuar të evidentuarat e PSV. Ky vlerësim është edhe në përputhje me kërkesat e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (2016-2020), e cila kërkon në mënyrë specifike që të qartësohen sa më saktë, roli e detyrat dhe përgjegjësitë e secilit institucion të mandatuar që të veprojnë në ofrimin e shërbimeve adekuatë për viktimat e dhunës në Familje.

Vlerësimi i zbatimit të PSV shërben si udhërrëfyes edhe për akterët kyç në ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes për viktimat e dhunës në Familje.

Po ashtu, mund të përdoret si udhërrëfyes edhe për hapat e mëtejshëm që duhet t'i ndërmerr Qeveria e RKS, në ndryshimin dhe plotësimin e procedurave në fjalë, në përputhje me kërkesat më të larta të standardeve të të drejtave të njërit në Kosovë, të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Qëllimi i këtij raporti nga hulumtimi i realizuar është pikërisht që të analizohet nëse zbatimi i deritanishëm i PSV ka qenë siç duhet si dhe të identifikohen sfidat dhe problemet kryesore që pengojnë zbatimin e saktë të tyre në praktikë.

Për vlerësimin e PSV janë mbajtur katër fokus-grupe të organizuara nga ABGJ, në Prishtinë, Gjakovë, Prizren dhe në Mitrovicë.

Hartimi i Vlerësimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është financuar nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GIZ.



ABGJ e mbështet iniciativën për Amandamentimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje



Agjencia për Barazi Gjinore bazuar në mandati e saj që buron nga Ligji për Barazi Gjinore, Neni 8, dhe përgjegjësitë e saj në cilësinë zv. Koordinatorit Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ka vazhduar mbështetjen e saj institucionale me qëllim të ofrimit të ekspertizës, mbështetjes në procesin e amandamentimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna Familje, iniciativë kjo e Komisionit Parlamentarë për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, persona të pa gjetur dhe peticione.

Gjatë vitit 2019 ABGJ ka mbështetur këtë iniciativë me ekspertizë në 5 punëtori, si dhe me ekspertizë përmes projektit mbështetës Niras –CPM International, dhe ka financuar me fonde vetanake realizimin e 3 punëtorive.

Agjencia rithekson domosdoshmërinë e trajtimit në mënyrë specifike brenda këtij ligji të dhunës në baza gjinore, si parakusht i përafrimit me kërkesat specifike të Konventës së Stambollit. Draft dokumenti nuk është finalizuar në përfundim të mandatit të komisionit, dhe ABGJ e ka vendosur këtë iniciativë në strategjinë legjislativë të Qeverisë për vitin 2020 si një aktivitet i cili planifikohet të finalizohet.

Amandamentimi i Ligjit inicohet në përputhje me kërkesat e reja të Kodit të ri Penal të Kosovës për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna në Baza Gjinore.

ABGJ ka mbajtur trajnim me anëtarët e Shoqatës së Grave të Shërbimit Korrektues në Kosovë



Shoqata e Gruas të Shërbimit Korrektues të Kosovës ka të bëjë me fuqizimin e rolit dhe pozitës së gruas në këtë Shërbim, vetëdijesimin mbi çështjet që kanë të bëjnë me gratë, promovimin e mos-diskriminimit dhe të barazisë gjinore, zhvillimin profesional dhe promovimin ndërkombëtar të Shoqatës, si dhe të lobimit për avansimin e vetëdijes institucionale dhe publike lidhur me rolin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në vendimmarrje të grave të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Synimi i përgjithshëm i Shoqatës së Gruas të Shërbimit Korrektues të Kosovës është angazhimi, me qëllim të përfshirjes në procesin e përkrahjes së avansimit të barazisë gjinore, dhe të rritjes së kontributit të grave të këtij Shërbimi për të siguruar llogaridhënie, mbrojtje të të drejtave të njeriut, si dhe të çështjeve të sigurisë, në fushëveprimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

ABGJ në bashkëpunim me Shoqatën e Grave të Shërbimit Korrektues të RKS ka mbajtur trajnim me temën "Dhuna në Familje dhe Ngacmimi seksual, ndikimet e këtyre dukurive negative në shoqëri".

Në këtë trajnim morën pjesë (30) tridhjetë gra, dhe trajnimi u mbajt nga Leonora Selmani, shefe e Divizionit për Legjislacion në ABGJ.

Trajnimi u mbështet me mjete financiare të Sides.

ABGJ në bashkëpunim me Un- Women ka mbajtur punëtori për Shoqatën e Grave në SHKK

Agjencia për Barazi Gjinore në partneritet me Un Women kanë organizuar trajnim dy ditor për anëtarët e Shoqatës së Grave të Shërbimit Korrektues në Kosovë.

Kjo iniciativë erdhi pas mbështetjes së ofruar nga Un Women, drejt krijimit të Shoqatës në fund të vitit 2018, ku menjëher u identifikua si nevojë ngritja e kapaciteteve të anëtarëve të saj, në fushën e legjislacionit që rregullon çështjet gjinore dhe jo diskriminuese.

Si rezultat, pesëdhjetë anëtarë të Shoqatës u mblodhën në Durrës, Shqipëri për të marrë pjesë në trajnimin intensiv mbi standardet dhe legjislacionin e njohur ndërkombëtar që ka të bëjë me çështjet gjinore, mosdiskriminimin dhe drejtësinë sociale.

Trajnimi është mbajtur nga Shefja e Divizionit të Legjislacionit e ABGJ-së, Leonora Selmanaj e cila përshkroi në thellësi kuadrin ligjor të mësipërm, duke përfshirë parimet e barazisë gjinore, pronat e grave dhe të drejtat e trashëgimisë, mbrojtjen nga dhuna në familje dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Sipas Udhëheqëses së Shoqatës, Zyrafete Imeraj, kjo shoqatë synon të forcojë pozitën e grave në

shërbim, si dhe njohuritë e fituara gjatë këtyre dy ditëve do të ndihmojnë në zbatimin e këtyre normave dhe standardeve në punën dhe shërbimet e tyre.



ABGJ ka mbështetur Komisionin Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës

Agjencia për Barazi Gjinore gjatë viti 2019 ka mbështetur Komisionin Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës me mbajtjen e punëtorisë tre ditore.

Punëtorja është mbajtur me qëllim të krijimit të standardeve për vlerësimin e provave dhe mënyrën e intervistimit në mënyrë që të krijohet një besueshmëri në procesin e verifikimit dhe të mundësohet që Komisioni të kryejë punë shpejtë dhe pa vonesa .

Gjatë kësaj punëtorie Komisioni ka përgatitur edhe planin e punës për vitin 2019 buxhetin për të njëjtin vit si dhe ka caktuar prioritetet .

Me qëllim të sensibilizimit të opinionit publik me vazhdimin e punës së Komisionit, mënyrën e aplikimit për njohjen e statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës dhe realizimit të kësaj të drejte por edhe krijimin e besueshmërisë në tërë procesin Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar video-spotin e dytë televiziv të financuar nga SIDA- Suedeze i cili u shfaq në Radio Televizionin e Kosovës.

Videospotin e gjeni në linkun e mëposhtëm

https://www.youtube.com/watch?v=czPFQ_8F7Gk

AKTIVITETET AVOKUESE

Shënohet 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas

16 Ditë e Aktivizmit



Me rastin e hapjes së Fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, organizoi tryezë diskutimi, ku është prezantuar Manuali për Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë Gjinore si dhe prezantimi i Vlerësimit të Zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edi Gusia, në hapje të fushatës theksoi se “Fushata e 16 ditëve të aktivizmit nuk është ngjarje festive; ajo është thirrje e ndërgjegjes për të gjithë shoqërinë për të: pyetur se a punuam mjaftueshëm për të mbrojtur të gjitha ato gra dhe vajza që ishin viktimat të dhunës në familje, dhunës në baza gjinore gjatë vitit 2019?

Fatkeqësisht, gjatë vitit 2019 kemi 6 jetë të humbura, 5 gra dhe vajza dhe një fëmijë, të cilët humben jetën si pasojë e dhunës në baza gjinore, si pasojë e një mentaliteti shumë sfidues, i cili ende minimizon pasojat e dhunës ndaj grave dhe reagimi vazhdon të jetë i ngadalshëm ndaj të gjitha atyre që kërkojnë ndihmën dhe mbështetjen tonë” theksoi znj. Gusia.

Ajo shtoi se ne si institucione kemi bërë hapa pozitiv në drejtim të përplotësimit të kornizës ligjore dhe mekanizmave institucional, që ofrojnë mbrojtje nga dhuna në familje dhe ajo në bazë gjinore.

Mirëpo, ka shumë nevojë të punohet në drejtim të ofrimit të një reagimi më të shpejtë dhe më të koordinuar ndaj thirrjes së të gjitha atyre grave që kërkojnë ndihmë për të shpëtuar nga një ambient apo situatë e dhunshme jetësore.

Angazhimin për ta eliminuar dhunën në baza gjinore, dhunën në familje sic tha Gusia duhet ta vëmë në qendër të agjendave tona politike, edukative dhe informuese, parandalimi dhe reagimi ndaj këtij fenomeni shkatërrues duhet të jetë prioritet politikë hartues, buxhetor dhe reagim kulturor.

Çështjet pronësore dhe trashëgimore, të cilat lënë vajzat dhe gratë të jetojnë në ambient familjarë të dhunshëm, mbështetja e iniciativave që krijojnë pavarësi ekonomike, përkujdesja sociale banesore

për të mbijetuarat e çfarëdo lloj dhune, financimi i strehimoreve, qasja në drejtësi, eliminimi i barrierave burokratike gjyqësore, kërkojnë angazhimin e institucioneve, universitetit, shoqërisë civile, mediave që të mos lejojmë të humbim jetë dhe të krijojmë mundësi për jetë të dinjitetshme, ku çdo grua dhe vajzë të ndjehet e mbrojtur dhe e sigurt.

Drejtoresha për Ndhimë dhe Zhvillim (Sida) nga Ambasada Suedeze, Nasrin Pourghazian, në fjalën përshëndetëse tha se "ne me ABGJ kemi një partneritet shumë të rëndësishëm dhe theksoi se përpos në Kosovë dhuna në baza gjinore ndodh edhe në Suedi dhe se ky nuk është një problem kombëtar, por është një problem global. Roli i qeverisë është shumë domethënës dhe si institucione ndikojnë pozitivisht në përmisimin e sistemit.

Ndërkaq, Reyes Charle Cuellar, Këshilltare për të Drejtat të Njeriut, në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, gjatë fjalës hyrëse tha: "se sot kam ardhur të përfaqësojë zyrën e BE-së, e cila edhe sot po diskuton për barazinë gjinore në Mitrovicën Veriore dhe në Prishtinë. ABGJ ka një mandat të gjerë dhe se ajo është e angazhuar seriozisht në luftën kundër dhunës së grave, derisa për BE është e drejtë fundamentale dhe në të gjitha marrëdhëniet me të tjerët i promovon dhe angazhohet për të drejtat e barabarta dhe avancimin e tyre".

Ndërsa, David Oberhuber, Shef për Bashkëpunim Ndërkombëtar-- GIZ tha se është i lumtur që përfaqëson GIZ dhe theksoi se dhuna në familje nuk është prezent vetëm në Kosovë, por edhe në Gjermani dhe se numri i grave të vdekura si pasojë e dhunës ndaj grave në vitin 2019 është 120.

"Sot po ashtu jam i lumtur që i kemi PSV dhe se duhet një angazhim i të gjithëve që të jeni sa me funksionale".

Prezantimin e Manualit për Vlerësimin e Ndikimit të Barazisë Gjinore, e prezantoi, Blerinda Idrizi, Udhëheqëse e Projektit Niras/CPM Internacional /Projekt i mbështetur nga SIDA, ndërsa Leonora Selmani - Shefe e Divizionit për Legjislacion ABGJ, prezantoi Vlerësimin e Zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje i cili u mundësua në Bashkëpunimin Ndërkombëtar GIZ.



Në fund të takimit është shfaqur videospoti televiziv i realizuar nga ABGJ rreth mekanizmave shëndetësorë, mbi përgjegjësitë e tyre karshi viktimave të dhunës në familje.

Në vazhden e aktiviteteve të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, ABGJ me datë 25 Nëntor nga ora 17:00- 24:00 është ndiçuar Ndërtesa e Qeverisë – Zyrës së Kryeministrit me simbolin e kordeles së bardhë dhe ngjyrën portokalli.



Po ashtu, në të gjitha ueb faqet zyrtare të Ministrive dhe Komunave është vendosur kordelja e bardhë si dhe është dërguar një komunikatë për media. Ku përmes saj ABGJ ka bërë thirrje për reagim të shpejtë të Institucioneve të Republikës së Kosovës të mandatuara të ofrojnë siguri, mbrojtje sociale, ekonomike, shëndetësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

ABGJ ka realizuar edhe një videospot televiziv, i cili është transmetuar në Radio Televizionin Publik të Kosovës lidhur me Institucionet shëndetësore në identifikimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në Familje. Përmes mbështetjes financiare të UNFPA-së ky spot është transmetuar edhe në tri televizione tjera private, si KTV, RTV21 dhe Klan Kosova.

ABGJ ka përgatitur edhe materiale promovuese, si çanta bezi me simbolin e kordeles së bardhë, fletore, kimika, ombrella, si dhe emblemën metalike.



Aktivitetet e fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit u mbuluan me mjete financiare të Agjencisë Sue-deze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar - SIDA.

Mediat qe kanë raportuar rreth aktivitetetve te ABGJ, gjatë fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit

<https://ëëë.koha.net/arberi/195643/n eser-fillon-fushata-e-16-diteve-te-aktivizmit-kunder-dhunes-ndaj-gruas/>

<https://fakteplus.net/gusia-dhuna-ne-baza-gjinore-la-te-vdekur-5-gra-dhe-nje-femije-gjate-2019-tes/>

<http://rtv21.tv/shenohet-dita-nderkombetare-per-eliminimin-e-dhunes-ndaj-gruas-2/>

<https://ëëë.aa.com.tr/sq/ballkani/kosov%C3%AB-sh%C3%ABnohet-dita-nd%C3%ABrkom-b%C3%ABtare-p%C3%ABr-eliminimin-e-dhun%C3%ABs-ndaj-gruas/1654857>

<https://kosova.info/gusia-dhuna-ne-baza-gjinore-la-te-vdekur-5-gra-dhe-nje-femije-gjate-2019-tes/>

https://klankosova.tv/katemisionet/lajmet/?emision_id=1172764

<https://fakteplus.net/ndertesa-e-qeverise-ndricohet-me-simbolin-e-kordeles-kjo-eshte-arsyeja/>

<http://top-channel.tv/2019/11/25/ndricohet-ndertesa-e-qeverise-ne-diten-nderkombetare-per-eliminimin-e-dhunes-ndaj-gruas/>

<https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=uyFhR-t7S0Q>

<https://klankosova.tv/ne-diten-kunder-dhunes-ne-baza-gjinore-ndricohet-ndertesa-e-qeverise1/>

<https://telegrafi.com/ne-diten-nderkombetare-per-eliminimin-e-dhunes-ndaj-gruas-ndertesa-e-qeverise-ndricohet-simbolin-e-kordeles-se-bardhe-dhe-ngjyre-portokalli/>


<http://ekonomia-ks.com/?page=1,21,383455>

<https://kosovapost.net/dita-nderkombetare-per-eliminimin-e-dhunes-ndaj-gruas-ndertesa-e-qeverise-ndricohet-me-simbolin-e-kordeles-se-bardhe-dhe-ngjyre-portokalli/>

<http://time.ikub.al/19-11-25-Ndertesa-e-Qeverise-ndricohet-me-simbolin-e-kordeles-per-eliminimin-e-dhunes-ndaj-gruas/Ndertesa-e-Qeverise-ndricohet-me-simbolin-e-kordeles-per-eliminimin-e-dhunes-ndaj-gruas.aspx>

<https://literal.media/Solidarizim-per-diten-kunder-dhunes-Qeveria-ndricohet-me-simbolin-e-kordeles/39294>

Shënohet 8 Marsi- Dita Ndërkombëtare e Gruas



Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me IPKO Foundation, Un Women, UNKT dhe UNICEF, kanë shënuar 8 Marsin – Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me organizimin e një punëtorie me temë: “Vajzat në inovacion për ndryshim”, duke thirrur për rritje të pjesëmarrjes së vajzave në shkencë, teknologji dhe inovacion, bazuar në temën globale të OKB-së, “Mendo për barazi, ndërto zgjuar, inovo për ndryshim.”

Duke pasur parasysh shkallën e ulët të pjesëmarrjes së grave në industrinë e teknologjisë në Kosovë, (më pak se 30%) qëllimi i kësaj punëtorie ishte theksimi i rëndësisë së investimeve teknologjike në fuqizimin e grave dhe vajzave si faktor themelor për thyerjen e transmetimit të varfërisë, dhunës, përjashtimit dhe diskriminimit mes gjeneratave, duke arritur mundësi të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në këtë takim moren pjesë pesdhjetë (50) vajza të reja nga dhjetë (10) Komunat të ndryshme të Kosovës, të cilat kishin mundësinë të përqëndrohen në të mësuarit si mjet fuqizimi në profesione të dominuara nga burrat.

Me këtë rast me një fjalë rasti këtë aktivitet e përshëndeti Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edi Gusia, duke theksuar se “ne jemi mbledhur sot të shënojmë 8 marsin në 108 vjetorin e shënimit të kësaj date, që për disa nga ju mund të ju duket një histori e largët, dhe fatmirësisht për gjeneratat e juaja është shumë e largët, mirëpo jo aq sa ta tejkalojmë pa e ditur pse shënohet, dhe se a ka ende nevojë të shënohet”.

8 Marsi nuk është datë festimi vetëm me lule, por është datë rikujtimi, dhe vlerësimi të sakrificës dhe punës së të gjitha atyre grave aktiviste në mbarë botën, që në 108 vitet e fundit kontribuan me aktivizmin e tyre për të drejtat që i gëzojmë sot ne si gra dhe vajza, që historikisht gratë dhe vajzat e botës nuk i kanë gëzuar, dhe që në shumë vende të botës ende nuk i gëzojnë.

Liria e gruas është fituar atëherë kur ju ka njohur e drejta e votës dhe e drejta e punës, dhe takimi i sotëm ka për qëllim që të ju inkurajoj në orientimin tuaj të ardhshëm si profesioniste, shkencëtare, inovatore.

Duke ndjekur ëndrrat e juaja, për profesionet që do t’i zhvilloni në të ardhmen, ju kontribuoni në të ardhmen e vendit tonë. Në përpjekje për të realizuar ëndrrat e juaja, ju realizoni të drejtat e juaja, dhe të drejtat dhe liritë nuk janë të mirëqena, për to duhet të punohet në vazhdimësi me seriozitet, përkushtim dhe pasion. Dhe kur flasim për punën, përkushtimin dhe pasionin, shkenca ndërtohet në këto parime, dhe këto parime duhet të ju udhëheqin në përzgjedhje të profesioneve tuaja të ardhshme.

Shkollimi, edukimi, punësimi krijon individ të lire dhe progresiv, dhe kjo do t'ju mbajë ju vajza në hap me trendet zhvillimore, jetë të shëndetshme, dhe ardhmëri të lirë larg situatave të dhunës dhe keqpërdorimit. Andaj, vëmendje parësore duhet kushtuar edukimit cilësor dhe vlerave që promovojmë, vlerave edukative, kulturore, sociale, dhe kjo nuk varët vetëm nga programet shkollore, programet për fuqizim ekonomik, por ka faktorë të shumtë që ndërlidhen dhe ndikojnë, dhe mediat janë një nga faktorët kyç (sidomos duke ditur rëndësinë që ato luajnë në jetën e të rinjve) përmes stereotipeve që krijojnë, dhe boshllëqeve që reflektojnë nëse nuk e promovojnë barazinë gjinore, diversitetin, dhe nëse kanë qasje diskriminuese, si dhe duke promovuar modele, kushtimisht të them të gabuara "suksesi" tek vajzat e reja.

Është koha të orientohemi për të krijuar një mendësi të re në kulturën tonë, duke ofruar më shumë hapësirë për vlera, mundësi të barabarta, dhe duke përfshirë sa më shumë djem në procesin e edukimit për barazinë gjinore, dhe njëkohësisht duke promovuar tek vajzat frymën garuese, dhe avancimin e bazuar në vlera. Legjislacioni është hapi i parë i cili garanton trajtim të barabartë, por konkurrimi i bazuar në vlera dhe kualitete duke motivuar vajzat e reja të jenë më aktive dhe të marrin pjesë me intensitet më të lartë në shkencë dhe procese zhvillimore të shoqërisë është synimi ynë i përbashkët.

Ndërsa, Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndermarrësisë, Besim Beqaj, theksoi përkrahjen e institucioneve të Kosovës për fuqizimin e grave dhe vajzave në fushën e inovacionit, si kontribuese të barabarta të ndryshimeve në shoqëri.

Koordinatorja për Zhvillim e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Ulrika Richardson, deklaroi se: "Gjatë jetës sime në Suedi kam qenë dëshmitare e ndryshimeve shoqërore, inovacionit dhe teknologjisë, të cilat u përshpejtuan nga përfshirja e grave dhe vajzave. Tani i shoh të njëjtat energji këtu, në ndërtimin e shoqërisë kosovare, duke bërë ndryshimin cilësor drejt arritjes së përfaqësimit të barabartë të grave dhe vajzave në fushat ku ato ishin - dhe ende janë - të nënpërfaqësuara; arsim, punë, politikë, inovacion dhe natyrisht teknologji! "

Ndërkaq, Abetare Gojani, drejtoreshë e programit në Ipko Foundation, fondacion që ka frymëzuar më shumë se një mijë vajza për t'u bashkuar me fushën e teknologjisë informative, theksoi: "Ne në Fondacionin IPKO bazojmë veprimet tona në besimin se kur ju fuqizoni gratë, ju fuqizoni gjithë shoqërinë".

Ky aktivitet u realizua me mbështetje financiare nga SIDA.



<http://ëëë.ekonomia-ks.com/sq/teknologji/ne-diten-e-grave-behet-thirrje-per-me-shume-vajza-ne-shkence-dhe-teknologji>

<http://kosova.info/shenohet-dita-nderkombetare-e-grave-me-thirrjen-per-me-shume-vajza-ne-shkence-dhe-teknologji/>

<https://ekonomiaonline.com/nacionale/shenohet-dita-nderkombetare-e-grave-me-thirrjen-per-me-shume-vajza-ne-shkence-dhe-teknologji/>

<http://ëëë.kosovapress.com/sq/lajme/grate-te-orientohen-me-shume-drejt-shkences-dhe-inovacionit-201377/>

<https://ëëë.botasot.info/aktuale-lajme/1044696/grate-te-orientohen-me-shume-drejt-shkences-dhe-inovacionit/>

<https://gazetablic.com/gusia-grate-dhe-vajzat-duhet-ti-ndjekin-endrrat-e-tyre-per-te-ardhmen-e-vendit/>

<https://freeneës.tv/grate-te-orientohen-me-shume-drejt-shkences-dhe-inovacionit/>

Në kuadër të shënimit të 8 Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar 24 bilborda dhe 300 fletushka me informacione rreth parandalimit të ngacmimit seksual në vendin e punës, bilbordat janë vendosur në qytete të ndryshme të Kosovës, si dhe fletushkat janë shpërndar gjatë aktiviteteve që ka pasur ABGJ.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED PREMIJERA
AGJENCIA PËR BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST POLOVA / AGENCY OF GENDER EQUALITY

NGACMIMI SEKSUAL NDALOHET ME LIGJET:

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NR. 04/L-082
LIGJI NR. 05/L-021 PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI
LIGJI NR. 05/L-020 PËR BARAZI GJINORE

Ngacmim seksual konsiderohet atëherë kur një sjellje e padëshirueshme përfshinë shkeljen e dinjitetit të personit dhe krijimin e një ambienti frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fyes. Nëse ju jeni viktimë e ngacmimit seksual, lajmëroni nga cmuesin /en se sjellja e tillë është e padëshirueshme dhe duhet të ndalet menjëherë. Raportoni incidentin me sa më shumë detaje, duke përfshirë emrin e ngacmuesit /es, datën, kohën dhe veprimin e kryer dhe gjuhën e përdorur. Kujdesuni që këto raportime të jenë edhe me shkrim dhe gjithmonë sigurohuni që të keni kopje të korrespondencave tuaja. Nëse jeni të ngacmuar seksualisht lajmëro rastin në linjën ndihmëse falas 24/h në Vala dhe Ipko, në numrin: 08001112 dhe merr shërbime të këshillimit se si të veprohet me tutje. Sigurohuni që zëri juaj të dëgjohet dhe të drejtat tuaja të respektohen.

Në shënim të 8 Marsit, Dita Ndërkombëtare e Gruas



www.abgj.rks-gov.net

Lajmëro rastin: **08001112**

Videospotetet e realizuara nga Agjencia për Barazi Gjinore





Sekuenca nga videospoti i realizuar për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve, të transmetuar në RTK

1) Agjencia për Barazi Gjinore ri kujton qytetarët/et e RKS se Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, është duke punuar me përkushtim për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, për të ju njohur të drejtat e juaja.




2) Statusi viktimë e dhunës seksuale i njihet personit që i ka mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit gjatë periudhës 27.02.1998 - 20.06.1999.

Sekuenca nga videospoti i realizuar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës së fundit, ku deri më tani me një proces të besueshëm 648 të mbijetuarve u është njohur statusi. Spoti është transmetuar në RTK

**NDALIMI I MARTESAVE TË HERSHME TË VAJZAVE
RRITË SHANSET PËR ZGJEDHJE POZITIVE PËR JETESË,
I MBANË ATO LARG VARFËRISË, LARG DHUNËS NË FAMILJË**

Zabrana ranih brakova povećava šanse devojčica da donesu pozitivne odluke o životu, drži ih



Sekuenca nga videospoti i realizuar për parandalimin e Martesave të Hershme, ku gjatë vitit 2016 kanë qenë 63 raste, në 2017- 60 raste, 2018- 49 raste, si dhe në vitin 2019 34 raste.

Ky videospot është perkthyer edhe në gjuhën rome, dhe është transmetuar në kuadër të emisionit Yekhip në RTK.

Institucionet shëndetësore, profesionistët shëndetësorë ne nivel vendi janë te obliguar :

- Te identifikojnë viktimën e dhunës në baza gjinore, dhunës në familje, kur kërkohet ndihma mjekësore nga viktima potenciale
- Te ofrojnë ndihmë mjekësore me prioritet, pa pagesë
- Te njoftoj policinë për viktimën e identifikuar. Mos paraqitja e rastit në polici paraqet vepër penale
- Përgatiti raporti me shkrim, të plotëson formularin mjekësor
- Te aplikoj protokollin e veçantë mjekësor dhe te regjistrojë viktimën në te
- Ruajtja e konfidencialitetit të dosjes mjekësore konform ligjeve

Çuvania nverllivnosti lekarskog dosijea u skladu sa zakonima.

Sekuenca nga videospoti i realizuar për obligimet e punëtorëve shëndetësor ndaj fenomenit të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore i transmetuar në RTK, si dhe në mbështetje të UNFPA-së. Ky videospot është transmetuar edhe në tri televizione tjera private RTV21, KTV si dhe në Klan Kosova.



Sekuenca nga videospoti i realizuar për përfshirje të barabart gjinore në proceset zgjedhore, i transmetuar në RTK. Po ashtu me mbështetje të Un Women është transmetuar në KTV, Klan Kosova si dhe T7.

Të gjitha videospotetë u realizuan me mbështetje financiare të SIDA-s

Përkrahja e Organizatave Joqeveritare që promovojnë Barazinë Gjinore

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore, Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, dhe dokumenteve tjera me rëndësi të cilat promovojnë mundësitë e barabarta, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/02/2012 për Subvencionimin e Projekteve nga Fusha e Barazisë Gjinore, si dhe mandatin të saj, ABGJ ka përzgjedhur projektet të cilat promovojnë barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, dhe fuqizimin ekonomik të tyre.

Personat fizik që kanë përfituar janë:

- Projekti : “Porosi Embëlësira te Flutra –Ëmbëlësira me Porosi” me përfaqësuese Fluturije Baliu, Ferizaj
- Projekti : “Kutivimi i Kërpudhës ” me përfaqësuese Mevlude Ramadani , Prishtinë
- Projekti : “ Pajisje për Rrobaqepësi” me përfaqësuese Adelina Gashi Lapushnik, Drenas
- Projekti : “ Aftësim profesional dhe vetëpunsim” , me përfaqësuese Albina Istogu , Drenas
- Projekti: Zhvillimi i biznesit familjar dhe prodhimi i mjaltës organike dhe nënprodukteve tjera të bletës ,me përfaqësuese Marigona Qorraj, Decan
- Projekti : “Ndërtimi dhe renovimi i dhomës së mjaltit, blerja e koshereve të bleteve +bletes ,” me përfaqësuese Fitnete Bunjaku, Samadregj, Vushtrri
- Projekti: “Ngritja e kapaciteteve të parcelës me bimë medicinale, duke instaluar rrethojat dhe sistemin e ujitjes ” me përfaqësime të Emine Avdyli , Shashkoc

Ndërsa OJQ-të përfituese janë:

- Qendra për promovimin e të drejtave të Grave, Drenas, Projekti: “ Fuqizimi ekonomik i të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës”,
- Shoqata “Uela” Projekti : “Kombinimi i traditës me modernen dhe përkrahja e grave vetsh-qyese për punësim”
- OJQ “Drugëza” Projekti: “Trashëgimia e shfaqur përmes veshjeve dhe punimeve artizanale tradicionale”
- OJQ “Melisa” Projekti: “Fuqizimi i Gruas me kultivimin e bletëve”
- OJQ “Joras Design” Projekti: “ Trajnimi/Shkollimi dhe integrimi i grave RAE ne shoqërinë Kosovare”,
- OJQ-Center for Education and development, Projekti: “ Parandalimi i dhunës në familje dhe ndaj gruas “
- OJQ “Sound of Kosova” Projekti: “Gratë për fuqizimin e grave përmes promovimit dhe ruajtjes së kulturës turke”
- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve/QMGF, Projekti : “Sensibilizimi i qytetarëve dhe institucioneve kundër dhunës në baza gjinore”
- K.B’ Kastrioti (femrat) Ferizaj, Projekti “Zhvillimi dhe përmirësimi i pozitës së grave në sport/Basketboll.
- Shoqata humanitare e prindërve me persona me aftësi të kufizuara mendore “Hader” Projekti : Kurs rrobaqepësie dhe punime artizanatesh me makine qepëse
- OJQ “Lulishtja Dita” Projekti: “Promovimi i të drejtave të grave të komunitetit RAE dhe fuqizimi i rolit të tyre në sfidimin e dhunës në familje”
- Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës, Projekti : “Një shikim ndryshe tek realiteti shoqëror”
- OJQ Inspiracija Projekti: “ Ruajtja e traditës dhe zanateve të vjetra”

Komunikatat për media**KOMUNIKATË PËR MEDIA****25 Nëntor 2019****Agjencia për Barazi Gjinore bën thirrje që t'i bashkoheni fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit!**

Fushata e 16 Ditëve të Aktivizmit është fushatë botërore që organizohet çdo vit dhe e cila fillon me 25 Nëntor, e njohur si Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas dhe përfundon me 10 dhjetor, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut.

Çdo vit përmes kësaj fushate anembanë botës bëhen thirrje për veprime globale për të rritur ndërgjegjësimin në mbarë botën për parandalimin dhe eliminimin e dhunës ndaj grave e vajzave. Simboli i fushatës është kordelja e bardhë, ndërsa ngjyra zyrtare e fushatës është portokallia me moton "Ti jepet fund dhunës ndaj grave" për të siguruar një të ardhme më të mirë ku respektohet jeta dhe e drejta për të jetuar të lira, larg çfarëdo lloji të dhunës qoftë ajo fizike, psikike, emocionale apo ekonomike, që cenon të drejtat e njeriut- të drejtat e grave dhe vajzave në mbarë botën.

Me rastin e shënimit të **25 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas**, Agjencia për Barazi Gjinore, tërheq vëmendjen në domosdoshmërinë e reagimit me kohë dhe sipas përgjegjësiwe institucionale të gjithë institucioneve shtetërore dhe mbarë shoqërisë ndaj fenomenit të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Dhuna ndaj grave edhe këtë viti vazhdon të jetë dukuri alarmuese në Kosovë, ku gjatë vitit 2019 kemi 5 gra të vrara nga personat më të afërm të tyre. Humbja e jetëve të tyre është humbje e pa falshme për shoqërinë tonë.

Mbrojtja e jetës dhe dinjitetit të grave dhe vajzave është tregues i sundimit të ligjit. Është obligim i çdo qytetari/eje të Republikës së Kosovës të lajmëroi rastin e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore tek institucionet përgjegjëse, në rastin kur e përjeton apo është dëshmitarë i një situate të tillë. Ne të gjithë kemi obligim ta ruajmë jetën dhe ta parandalojmë dhunën në baza gjinore për të krijuar një ambient të sigurt si parakusht i paqes, ku vajzat dhe gratë ndjehen të lira dhe të mbrojtura.

ABGJ bën thirrje reagim të shpejtë të Institucioneve të Republikës së Kosovës të mandatuara të ofrojnë siguri, mbrojtje sociale, ekonomike, shëndetësore dhe psikologjike për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Bëjmë thirrje për ngritje të nivelit të bashkëpunimit mes institucioneve, organizatave të shoqërisë civile, dhe senzibilizimit të mediave, sepse vetëm me përpjekje të përbashkëta mund t'i japim fund dhunës në baza gjinore, për të krijuar një shoqëri të sigurve e cila mbron jetën dhe garanton sigurinë e qytetareve të saj.

ABGJ përkrahë fushatën globale për parandalimin e dhunimit seksual dhe ngacmimit seksual si fenomen negativ mbarë botërorë i cili shkakton humbje jetësh dhe cenon rëndë dinjitetin e vajzave dhe grave në mbarë botën. Dhuna seksuale është e pa tolerueshme.

Këtë vit, ABGJ e shënon hapjen fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, me datë 25 Nëntor me organizimin e një tryeze diskutimi ku do të prezantohet "Manualin për Vlerësimin e Ndikimit Gjinator "si dhe "Raporti mbi nivelin e zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga dhuna në familje", si dhe me transmetimin e një videoklipi televiziv i cili rithekson rolin e stafit shëndetësor në identifikimin e rasteve të dhunës, ofrimin e përkujdesjes profesionale për ta respektuar jetën e viktimave dhe mbrojtur dinjitetin e tyre.

Ndërsa, nga ora 17:00-24:00, Ndërtesa e Qeverisë- Zyra e Kryeministrit do të ndriçohet me ngjyrën portokalli dhe simbolin e fushatës kordeles së bardhë.

Komunikatë për Media – Të respektohet Ligji për Barazi Gjinore për përfaqësim të barabartë 50% me rastin e zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit 2019

Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) e Republikës së Kosovës, ju përkujton subjekteve politike, të cilat garojnë në fushatën elektorale për zgjedhje parlamentare Tetor 2019, respektimin dhe zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore të Kosovës Neni 6-të, Pika (8-të) për përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative me përfaqësim 50 % (për qind) për secilën gjini.

Agjencia ju përkujton subjekteve politike se një përfaqësim i barabartë gjinor në vendim-marrjen politike e legjislative të vendit është reflektim dhe zbatim i drejtpërdrejtë si dhe jetëson Kushtetutën e Kosovës sipas së cilës: “Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore”.

Barazia gjinore, e reflektuar përmes pjesëmarrjes së barabartë 50% për secilën gjini është vlerë themelore për ndërtimin e një shoqërie demokratike. Parimi i 50% duhet të përshkojë listat zgjedhore për përfaqësim të barabartë duke respektuar masën afirmative, programet e partive politike me propozime konkrete për pjesëmarrje, përfaqësim dhe zhvillim të barabartë dhe cilësor mes gjinive, fuqizimin socio-ekonomik të grave, dhe nxitjen e pjesëmarrjes në votime të grave dhe burrave në Kosovë. Për të arritur barazinë e vërtetë gjinore dhe për të gëzuar të drejta të plota njerëzore, ndryshimet duhet të jenë konkrete, të shpejta, vendimtare, të dukshme dhe gjithëpërfshirëse, prandaj duhet të kontribuojnë të gjithë që të shënojmë progresin që na detyron korniza ligjore e Kosovës dhe ardhmja Evropiane të cilën synojmë.

Parimi i përfaqësimit të barabartë prej 50 % për secilën gjini po ashtu duhet të reflektohet edhe në trupat mbikëqyrëse të zgjedhjeve - Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e vendvotimit.

Gjithashtu subjektet politike duhet të angazhohen plotësisht në sigurimin dhe përkrahjen financiare të fushatës së kandidateve gra në mënyrë të barabartë sikurse dhe për kandidatët burra, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, Ligjin për Financimin e Partive Politike dhe Ligjin Për Zgjedhjet në Republikën e Kosovës.

Agjencia për Barazi Gjinore ju përkujton subjekteve politike që gjatë fushatës elektorale në gjuhën e përdorur në takime me elektoratin, programet dhe premtimet elektorale, materialet promovuese të subjekteve politike të evitojnë gjuhën seksiste, të dhunshme, dhe stereotipet gjinore.

Agjencia për Barazi Gjinore ju bën thirrje mediave që të ofrojnë hapësirë të barabartë për gratë kandidate që të shpalosin programin e tyre. Paraqitja mediale është e rëndësishë së veçantë në fushatë zgjedhor, dhe ajo duhet të jetë e qasshme dhe transparente për të gjithë kandidatët pa dallim gjinie.

Ndërtimi i një shoqërie me vlera demokratike që punon për harmoninë shoqërore përmes promovimit të vlerave dhe parimeve të barazisë gjinore, i kontribuon paqes dhe mund të arrihet vetëm përmes konsensusit, dialogut, respektit për diversitetin e mendimit, përkatësisë ideologjike, gjinore, etnike e kulturore, respektim të të drejtave dhe lirive të individit.

Po ashtu, rikujtojmë se bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore Neni 5 pika 2, thekson se: Çdo dispozitë, e cila është në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë sipas këtij Ligji shfuqizohet.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET RELEVANTE

Përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore vizituan Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes në Ferizaj





Me ftesë të Zyrtares për Barazi Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes, në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit, përfaqësues të Agjencisë për Barazi Gjinore realizuan një vizitë pune në Kazermën “Skënderbeu” të Komandës së Doktrinės dhe Stërvitjes në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Ferizaj.

Gjatë vizitës në kazermën “Skënderbeu” stafi i ABGJ u prit në takim nga Komandanti i KDS Gjeneral brigade, Irfete Spahiu dhe stafi i KDS, ku patën mundësinë të njoftohen për misionin e FSK-së, në respektimin e të drejtave të grave në FSK, sigurimin e një ambienti të përshtatshëm dhe një sistem të vlerave ku grat dhe pakica jo shumicë trajtohen me dinjitet dhe kanë mundësi të barabarta.

Komanda e Doktrinės dhe Stërvitjes organizon dhe drejton përgatitjen, trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të FSK-së.

Takimet vazhduan në objektet e trajnimit dhe akomodimit, si dhe tek njësitë e KDS dhe kurset që ofrohen.

Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ-së prezantoi në Konferencën me temë Fuqizimi Ekonomik i Grave, Roli dhe Ndikimi i tyre në Komunitet

Me rastin e shënimit të 16 Vjetorit të Klubit Soroptimist Internacional, është organizuar konferencë me temë “Fuqizimi Ekonomik i Grave, roli dhe ndikimi i tyre në komunitet”.

Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore Edi Gusia, gjatë takimit theksoi se “Të krijosh barazi gjinore do të thotë të vendosësh prioritetet; sociale, kulturore, politike dhe ekonomike që në qendër vënë njeriun pa dallim gjinie, etnie, moshe, orientimi seksual, apo fetar, mirëpo për të përfshirë të gjithë në mënyrë të barabartë do të thotë të krijosh kushte elementare që nga ofrimi i hapësirës për të artikuluar kërkesat deri të qasja të jetë e barabartë në kushte për zhvillim për të gjithë”. Klubi i parë Soroptimist në Kosovë është themeluar me 15 nëntor 2003. Soroptimist Internacional është organizatë e cila ndihmon, vepron dhe zbaton projekte në përputhje me programet ndërkombëtare që përfshijnë disa fusha, të tilla si: -Të drejta të njeriut (Avancimi i statusit të grave) - Edukimi dhe kultura -Zhvillimi ekonomik dhe social -Ambienti -Shëndeti -Mirëkuptimi, mirëqenia dhe miqësia.

Përfaqësuesit e ABGJ prezantuan në Konferencën me temë “Procesi i njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës: Progresi dhe sfidat”



Konferenca u organizua nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë së Ambasadës së SHBA-ve në Kosovë. Kjo konferencë u organizua në kuadër të shënimit të 19 vjetorit të Rezolutës 1325 të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë dhe përmes të dy paneleve të diskutimit synoi të adresonte përparimin e bërë në procesin e verifikimit dhe njohjes së statusit të personave të dhunuar gjatë luftës.

Praktikat dhe standardet e ndërtuara në Kosovë, sfidat e procesit të verifikimit dhe njohjes, rëndësinë e bashkëpunimit institucional me shoqërinë civile, nevojat për përpjekjet e përbashkëta në luftimin e stigmës dhe çështje të tjera lidhur me dhunën seksuale si mjet lufte, ishin pjesë e diskutimeve.

Rrjeti i Grave në Shkencë dhe Arsim të Lartë në mbështetje të ABGJ kanë mbajtur punëtori njëditore për planifikimin e aktiviteteve për vitin 2020



Rrjeti i Grave në Shkencë dhe Arsim të Lartë me mbështetje nga Agjencia për Barazi Gjinore si dhe të Un Women, kanë mbajtur punëtorinë njëditore për planifikimin e aktiviteteve të RRGSHAT për vitin 2020.

Qëllimi i Rrjetit të Grave në Shkencë dhe Arsim të Lartë është promovimi dhe përkrahja e vajzave dhe grave në avancimin akademik, shkencor dhe lidhshëm, në promovimin e punës shkencore, kërkimore dhe udhëheqëse me qëllim të arritjes së potencialit të tyre të plotë dhe një karriere të suksesshme, të përkrahë vajzat dhe gratë në zhvillimin e karrierës së tyre akademike dhe shkencore përmes aktiviteteve të rrjetëzimit zhvillimor profesional dhe promovimit të bashkëpunimit, të promovojë rolin e vajzave dhe grave akademike në shkencë dhe edukim duke vendosur një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet grave në shkencë dhe edukim dhe organizatave që merren me avancimin e barazisë gjinore dhe politik-bërësve të të gjitha niveleve institucionale.

Pjesëmarrës në punëtori ishin: Grupi iniciues i RRGSHAL, Agjencia për Barazi Gjinore, Përfaqësues të Konferencës së Rektorëve, UN Women Kosovo, Gra nga academia dhe arsimi i lartë, përfaqësues të projektit HERAS.

Kjo punëtori kishte si qëllim, hartimin dhe harmonizimin e aktiviteteve të rrjetit për vitin 2020, si dhe u mbështet nga mjetet financiare të Sida-s.

U mbajt tryeza e diskutimit - Përfaqësimi gjinor në nivel lokal dy vjet pas zgjedhjeve lokale



Nën organizimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe në bashkëpunim me OSBE, është organizuar tryeza e diskutimit me temë përfaqësimi gjinor në nivelin lokal dy vite pas zgjedhjeve lokale.

Në takim morën pjesë përfaqësues të vetëqeverisjeve lokale, institucioneve të tjera qeveritare, përfaqësues të sektorit joqeveritar lokal si dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare.

Gjatë tryezës Ministria në MAPL Adiana Hodžić, ka theksuar se: Në dy vitet e kaluara është regjistruar progresi i përfshirjes së grave në institucionet lokale, por qëndron fakti se ky parim nuk ka arritur nivelin e duhur. Sipas saj, është e domosdoshme që të zbatohen plotësisht të gjitha ligjet dhe mekanizmat institucionale në luftën kundër diskriminimit dhe marginalizimit të grave në të gjitha sferat e jetës dhe proceset që ndodhin në shoqërinë tonë.

Pjesë e panelit ishte edhe Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edi Gusia, e cila theksoi se takimet tona të përbashkëta si ky janë thirrje për të gjitha institucionet që t'i bashkëngjiten misionit që shoqëria, institucionet publike dhe private të punojnë më shumë në drejtim të fuqizimit të vajzave dhe grave dhe sjelljen e zërit të tyre në vendimmarrje për të ngritur qeverisjen demokratike dhe të drejtën sociale në Kosovë.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave janë të domosdoshme për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit duke vendosur nevojat e grave dhe vajzave në qendër të vëmendjes në procesin e zbatimit të politikave publike në mënyrë koherente, me resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore, me monitorim të zbatimit në kontinuitet, me indikatorë gjinore, dhe me vullnet për të rishikuar vendimet në të mirë të gjithë përfshirjes së grave dhe grupeve tjera të marginalizuara, për ti sjellë brenda agjendës së zhvillimit dhe mirëqenies.

Gjithashtu, nga MAPL u ndanë certifikatë për përfaqësim gjinor në nivel lokal, për Kryetarin e Drenasit, Ramiz Lladrovci si dhe për Kryetarin e Kamenicës, Qëndron Kastrati, të cilët u vlerësuan me përfomancën më të mirë bazuar në indikatorët e performancës gjinor.

ABGJ ka prezantuar në tryezën me temë “Integrimi Gjinator në Nivel Lokal”

Në kuadër të programit të USAID-it për Veprimtarinë Lokale dhe Efektive të Qeverisë (LEGA) për të siguruar përfshirjen gjinore në qeverisjen lokale, u organizua një tryezë diskutimi me temë Integrimi Gjinator në nivel lokal.

Qëllimi i politikave të barazisë gjinore është ruajtja, trajtimi dhe vendosja e barazisë gjinore si një vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë kosovare. Politikat e barazisë gjinore ofrojnë mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e grave dhe burrave në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fusha të tjera.

Me këtë rast LEGA në bashkëpunim me përfaqësitë të Institucioneve të Kosovës kanë diskutuar për mbështetjen e komunave për forcimin e mekanizmave institucional gjinor si dhe përmirësimit të politikave të barazisë gjinore dhe përfshirjes së grave në proceset vendimmarrëse në nivel lokal.

Pjesëmarrës në panel ishin, Udhëheqësi i projektit të LEGA, Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ-së, Edi Gusia, ZBGJ në Komunën e Obiliqit, përfaqësues nga MAPL si dhe nga Un Women.

Gjatë tryezës Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ, Edi Gusia, prezantoi aktivitete që ABGJ ka ndërmarrë në përmirësim të pozitës së gruas në vend, konkretisht për Rregulloren e miratuar nga Qeveria e RKS, e cila është në fuqi për përshkrimin e detyrave të ZBGJ-ve, dhe vendosja e zyrtarëve për barazi gjinore në të gjitha Ministrinë e linjës dhe Komuna, si dhe institucione tjera publike si pjesë e strukturave të pozicionuara në nivele më të lartë të llogaridhënies, ku në nivel ministrie ZBGJ i përgjigjet Sekretarit të Përhershëm, ndërsa në nivel komune –Kryetarit të Komunës.

Kosova i ka parapri procesit të krijimit të strukturave të qëndrueshme për barazi gjinore. Kjo rregullore është udhërrëfyes për përfshirjen e ZBGJ-ve si mekanizmave gjinor nga proceset e politikë- hartimit, zbatimit dhe monitorimit. Është instrument për përcimin e barazisë gjinore në procese, sisteme të strukturave të administratës publike dhe fasciliton zhvillimin dhe zbatimin e agjendës kombëtare për barazi gjinore në nivel vendi.

Praktikat e deritanishme kanë treguar se përjashtimi i mekanizmave gjinor nga proceset e politikë-hartimit cenon integrimin gjinor cilësor në politikat zhvillimore dhe legjislacion, duke afektuar kështu efikasitetin dhe efektivitetin e politikave në tërësi, dhe mungesën e qasjes adekuate të gjithë qytetarëve ndaj këtyre politikave dhe të mirave që ato prodhojnë dhe që dashje pa dashje thellojnë pa barazitë gjinore dhe shoqërore.

Përfaqësuesit e ABGJ-së ishin pjesë e Konferencës me temë “Le të kthejme fuqinë për më shumë barazi gjinore» e cila u mbajt në Bruksel



Vitet e krizës, ndikimi në rritje për zërat radikal të anës së djathtë dhe sensi i “lodhjes gjinore” që kanë patur ndikim në qeveritë e BE-së” - përkushtimi për barazi gjinore, hulumtimi i ri nga IEBGJ që tregon se Shtetet Anëtare janë duke alokuar më pak vëmendje për strukturat institucionale që kanë ndihmuar që të kufizohet zbrazëtira në mes të grave dhe burrave, “Progresi për barazi gjinore nuk mund të merret si dhuratë” tha Virginija Langbakk, Drejtoreshë e IEBGJ-së.

“Qeveritë kanë nevojë që të kthejnë fuqinë dhe të ofrojnë burime adekuate për mekanizmat gjinor që këshillojnë barazinë gjinore”

Derisa të gjitha Shtetet anëtare kanë organe qeveritare të barazisë gjinore, disa anëtarë kanë ulur pozitën në hirearkinë qeveritare dhe i kanë ulur funksionet e tyre.

Trendet në dekadën e kaluar kanë rezultuar në organe të pavarura të barazisë gjinore të shkrihen me organizata anti-diskriminuese.

Përkushtimi për përfshirjen gjinore është dobësuar që nga viti 2012, me një të katërten e Shteteve Anëtare duke përfshirur në shumë fusha. Dhe derisa shtetet Anëtare kanë metoda dhe mjete për të mbledhur të dhënat e shpërndara, prodhimin dhe shpërndarjen që mungon në disa vende. Kjo mund të jetë e vështirë që të vlerësohet në mënyrë adekuate për situatën e barazisë gjinore.

“Nëse ne dojmë të shohim progres, barazia gjinore duhet të ketë sukses të plotë në çdo etapë për procese politike nga mbledhja e të dhënave të shpërndara gjinore deri te veprimet e vlerësimit sensitiv gjinor. Ky qëllim i mainstream-it gjinor për të cilin Shtetet Anëtar të BE-së janë të përkushtur që nga viti 1995 kur ata kanë pranuar Platformën e Pekinit për Veprim në Konferencën Botërore të KB-e për Gratë”, tha Barbara Limanovska, Kordinatore e Programit të Mainstream-it Gjinor të IEBGJ-së.

Raporti vijues “Mekanizmi Institucional për Barazi Gjinore dhe Mainstream Gjinor” krahason të dhënat nga viti 2018 me të dhënat e mbledhura në vitin 2012 për të vlerësuar trendet e përkushtimeve qeveritare për barazinë gjinore.

Përfaqësuesit e ABGJ morën pjesë në Konferencën për Indeksin e Barazisë Gjinore 2019, mbajtur në Bruksel



Nën organizimin e Institutit Evropian për Barazi Gjinore është mbajtur konferenca për prezantimin e Indeksit të Barazisë Gjinore 2019, ku kanë marr pjesë afër 300 vendimmarrës dhe praktikues për të diskutuar gjetjet e këtij indeksi dhe rezultatet e reja për barazinë gjinore në BE, si dhe të rishikohen fushat për përmirësim në kontekstin aktual politik.

Një tipar i ri i Indeksit të Barazisë Gjinore të këtij viti është një fokus i veçantë në ekuilibrin e punës dhe jetës. Konferenca do të eksplorojë mënyrat e ndryshme që gratë dhe burrat të balancojnë punën dhe angazhimet personale. Aspekte të tilla si pushimi prindëror, rregullimet fleksibile të punës dhe infrastruktura publike do të shqyrtohet dhe diskutohen nga folësit në panel.

Ndërsa, në ditën e dytë ABGJ mori pjesë në takimin e 10-të koordinues të shteteve kandidate të EU-së dhe shteteve potenciale kandidate.

Qëllimi i takimit ishte të mbledhin palët e interesuara nga rajoni për të diskutuar mënyrat e bashkëpunimit dhe përmirësimit të barazisë gjinore në nivel kombëtar dhe rajonal, Identifikimi i përparësive dhe diskutimi mbi zhvillimet e Indeksit Kombëtar të Barazisë Gjinore, si dhe Roli dhe perspektiva e shoqërisë civile, diskriminimi dhe puna në bazë gjinore në Ballkanin Perëndimor.

<https://eige.europa.eu/gender-equality-index/2019-conference>

ABGJ mori pjesë në takimin konsultativ rajonal ndërqeveritar për rishikim e platformës së Pekinit (B + 25), mbajtur në Shkup



Me rastin e shënimit të 25 vjetorit të miratimit të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, në Shkup, në organizim të UNCEF dhe me ftesë të UN WOMEN, Agjencia për Barazi Gjinore mori pjesë në takimin konsultativ rajonal ndërqeveritar për rishikim e platformës së Pekinit (B + 25) .

ABGJ prezantoi për të arriturat në drejtim të zbatimit të politikave publike si Plani i Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 dhe hapat e ndërmarrë në drejtim të vlerësimit të zbatimit të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2009-2013 si dhe hartimin e PKBGJ- së 2019-2022.

Kryeshefja Ekezkutive e ABGJ, Edi Gusia, prezantoi në Forumin Rajonal për Konventën e Stambolit, në Tiranë



Me ftesë të Un Women, Agjencia për Barazi Gjinore mori pjesë në forumin e dytë regional “Promovimi dhe Implementimi i Konventës së Stambollit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi” të mbajtur në Tiranë, Shqipëri.

Përfaqësuesit nga ABGJ prezantuan për të arriturat në drejtim të implemmentimit të konventës së Stambollit, legjislacionin dhe mekanizmat koordinues ne nivel qendror dhe lokal.

Gjithashtu u diskutuan sfidat dhe rekomandimet për të ardhmen në drejtim te zbatimi të kësaj Konvente.

Forumi Rajonal për Promovimin e Implementimit të Konventës së Stambollit në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi ka vazhduar punimet nga datat 9-10 Tetor 2019 me qëllim të ndarjes së praktikave më të mira dhe sigurimin e bashkëpunimit të të gjithë aktorëve për të përmbushur rekomandimet e Grevios, për një përgjigje të integruar për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe zbutjen e pabarazisë gjinore në nivel rajonal, kombëtar dhe lokal.

ABGJ mori pjesë në forumin dy ditorë, ku u diskuta mbi përfundimin e përzgjedhjes së seksit të njëanshëm gjinor, mbajtur në Stamboll



Me ftesë të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), dhe Qendra Ndërkombëtare e Fëmijëve (ICC) përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore morën pjesë në forumin dy ditorë me temë “Preferenca e djemve dhe nënvlerësimi i vajzave”, ku u siguroi një platformë për shkëmbimin e njohurive mbi preferencat e djemve dhe zgjedhjen e seksit të njëanshëm dhe për të nxitur shkëmbim dhe bashkëpunim Jug-Jug midis vendeve të prekura.

ABGJ mori pjesë në takimin e nëntë, të shteteve anëtare dhe para anëtarësimit, mbajtur në Turqi



Përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore me ftesë të Institutit Evropian për Barazi Gjinore kanë marr pjesë në takimin e nëntë të akterëve nga rajoni, për të diskutuar mënyrat e bashkëpunimit dhe për të përmirësuar barazinë gjinore në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe për të identifikuar përparësitë dhe për të diskutuar planin e punës për vitin 2019.

Nga ABGJ u prezantuan aktivitete për vitin 2018 si dhe për prioritetet e vitit 2019. Ku gjatë kësaj periudhe ABGJ ka mbajtur punëtorit për hartimin e PKBGJ, i cili tanimë veçse është në finalizim, ka mbajtur trajnime për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor, ka publikuar Ex post-in e LBGJ, trajnime për PSV, si dhe ka vazhduar me masën afirmative për regjistrimin e pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve edhe për vitin 2019.

Kryeshefja Ekzekutive e ABGJ, Edi Gusia, mori pjesë në konferencën me temë “Ne nuk jemi armë të luftës”, të mbajtur në Luksemburg



Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, Edi Gusia mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të inicuar nga Lartëmadhëria Dukesha e Luksemburgut Maria Tereza dhe në partneritet me Foundationin Dr. Denis Mukëege “Ne nuk jemi armë të Luftës”. Konferenca u mbështet nga Qeveria e Luksemburgut në bashkëpunim me Forumin e Grave për Ekonomi dhe Shoqëri që është mbajtur me datë 26-27 mars 2019 në Luksemburgë.

Lartëmadhëria Dukesha Maria Tereza ka organizuar këtë konferencë me qëllim të adresimit, izolimit dhe stigmës për të mbijetuarat e dhunës seksuale në konfliktet e armatosura.

Mukëege është një kirurg gjinekologjik me famë botërore, si dhe themeluesi dhe drejtori mjekësor i Spitalit Panzi në Bukavu, Republika Demokratike e Kongos. Ai njihet si eksperti kryesor në botë për “riparimin” e dëmit të brendshëm fizik të shkaktuar nga përdhunimi. Së bashku me ek-

ipin e tij, ai trajtoi më shumë se 50,000 viktima në lindje të Kongos. Në vitin 2018 ai mori Çmimin Nobel për Paqen, së bashku me një aktiviste jezidi dhe të mbijetuar nga përdhunim Nadia Murad, për përpjekjet e tij për t’i dhënë fund përdorimit të dhunës seksuale si armë lufte dhe në konflikt të armatosur.



AKTIVITETET E ZYRTARËVE PËR BARAZI GJINORE NË MINISTRI DHE KOMUNA

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Mbrojtjes, ka raportuar për rëndësinë dhe kushtet që kjo ministri ofron në respektimin dhe avancimin të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Infrastruktura ligjore e MM/FSK, garanton mundësi të barabarta pa dallim gjinie dhe etnie, për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e FSK-së, si dhe përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi. Me rekomandimin e Njesisë për të Drejtat të Njeriut dhe Barazi Gjinore, është miratuar propozimi që në programin e Qendrës për Stërvitje Bazike të ligjërohet për barazinë gjinore dhe perspektivën e saj, e që ka për qëllim vetëdijësimin e pjesëtarëve të FSK për barazinë gjinore, eliminimin e diskriminimit gjinor, stereotipeve negative, pabarazinë dhe paragjykimet. Programi i QSB ofron ligjëratat për Trajnimin Bazik për Komponentin aktiv dhe rezervë, ndërsa Shkolla e Nën Oficerëve në tri programet zhvillimore për nënoficerët e FSK, realizon 10 orë mësimore për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe ngacmimet seksuale.

ZBGJ me qëllim të ngritjes së transparencës, mundësive të barabarta dhe jo diskriminuese gjatë vitit 2019, ka vëzhguar procesin e rekrutimit, përzgjedhjes së rekruteve të rinj të FSK-së. Lidhur me këtë proces, është raportuar për mbarëvajtjen e procesit me të gjetura dhe rekomandime.

Gjatë vitit 2019, në komponentin aktiv të FSK-së janë rekrutuar 102 pjesëtare gra, ndërsa 569 pjesëtarë të gjinisë mashkullore janë rekrutuar në komponentin aktiv të Forcës.

Me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të përfshirjes së gjinisë femërore dhe progresit të tyre në karrierë ZBGJ në harmoni me Ligjin për Barazi Gjinore, ka rekomanduar që në kushte të barabarta të kenë përparësi gjinia më pak e përfaqësuar. Këto rekomandime janë përsëritur gjatë pjesëmarrjes në cilësi të vëzhguesit në Borde për Trajnim Bilateral si dhe në raportet periodike.

Gjatë vitit 2019, në total kanë ndjekur trajnime bilaterale 240 pjesëtarë (ushtarak dhe civil) prej tyre 21 gra (8.75%) dhe 219 burra (91.25%)

Gjatë këtij viti janë graduar gjithsej 106 gra ushtarake dhe gjithsej 704 pjesëtarë (ushtarak) burra.

Sa i përket statistikave aktuale në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në FSK është siç vijon:

Numri i përgjithshëm i grave dhe burrave në MM (Ushtarak dhe Civil) 53 Ushtarak në MM (Tre (3) Gra dhe 50 Burra), 106 Civil në MM (30 Gra dhe 76 Burra).

Numri dhe përqindja e grave në MM (civil) 30 Gra (civil) janë aktualisht në MM apo 28.30%, ndërsa burranë MM (civil) 76 Burra (civil) janë aktualisht në MM apo 71.70%.

Numri i përgjithshëm i grave në uniformë në MM / FSK – në MM / FSK në uniformë shërbejnë 300 gra (ushtarake) apo 10.80% nga numri i përgjithshëm.

Numri dhe përqindja e burrave në uniformë në MM / FSK -Aktualisht në MM / FSK në uniformë shërbejnë 2477 burra (ushtarak) apo 89.20% e forcës së përgjithshme.

Numri dhe përqindja e grave në MM, në pozita udhëheqëse (për Civil), 10 gra shërbejnë në pozita udhëheqëse në MM, apo 20.83% nga numri i përgjithshëm i pozitave udhëheqëse në MM. Numri dhe përqindja e burrave në MM, në pozita udhëheqëse (për Civil) 38 punonjës civil të gjinisë mashkullore (prej tyre tre (3) janë ushtrues detyre), shërbejnë në pozita udhëheqëse në MM apo 79.17% nga numri i përgjithshëm i pozitave udhëheqëse në MM.

Numri i grave në FSK, sipas gradave - Sikurse u cek më lartë, për momentin në MM / FSK shërbejnë 300 gra ushtarake në grada të caktuara si në vijim: Gjeneral brigade (OF6) – një (1), Nënkolonel (OF4) – katër (4), Major (OF3) – gjashtë (6), Kapiten (OF2) – gjashtë (6), Togjer (OF1) – tre (3), Nëntogjer (OF1*) – dy (2), Rreshter Major (OR9) – një (1), Rreshter i Parë / Rreshter Master – pesë (5), Rreshter i Klasit të Parë – shtatë (7), Rreshter Shtabor – katër (4), Rreshter – 25, Tetar / Specialist – 103, Ushtar i Klasit të Parë – 31, dhe Ushtar – 102.



Aktivitet i realizuar nga MFSK

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë gjatë vitit 2019 ka bërë vizita monitoruese siç është paraparë me planin e punës në institucione publike shëndetësore të kujdesit primar, sekondar dhe terciar me qëllim të njoftimit për se afermi, respektimit të legjislacionit në fuqi. Informimi i profesionistëve shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për viktimat e dhunës në familje dhe shpërndarje të materialeve sipas legjislacionit.

Sa i përket pozitive vendimmarrëse sipas gjinisë në MSH është siç vijon: Numri i Përgjithshëm i pozitive vendimmarrëse të stafit të MSh-së është 155 ku përfshihen: 96 Administrat, 7 Divizioni i Kujdesit Parësor, 29 Inspektorat Faramceutik Inspektorati Shëndetësor, 23 Kabinet; Pozitat vendimmarrëse, gra/burra: 14 Drejtor, kurse 2 Drejtoresha.

Përfituesit e trajnimeve gjatë vitit 2019, janë 64 gra dhe 48 burra; Përfituesit e vendeve të reja të punës gjatë vitit 2019: 11 gra, 7 Burra;

Gjatë vitit 2019 janë realizuar vizita monitoruese në institucione publike shëndetësore të kujdesit primar, sekondar dhe terciar, nëkomunën Vushtrri, Mitrovicë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Prishtinë.

Kurse për dhunën në familje sipas Procedurave standarde të veprimit dhe Udhërrefyesit mbi dhunën e bazuar në gjini për ofruesit e shërbimeve shëndetësore janë iniciuar dhe realizuar trajnime dhe tryeza të rrumbullakëta me profesionist shëndetësor në shtatë regjione të Republikës së Kosovës për stafin mjekësor, përfshi spitalet regjionale, QKUK-emergjenca, klinika gjinekologjike dhe psikiatrike, QKMF, dhe Qendrat e Shëndetit Mendor, pjesëmarrës kanë qenë 210 profesionist shëndetësor; tema e trajnimit: identifikimi, trajtimi, referimi nga profesionistët shëndetësor për dhunën e bazuar në gjini, dhunën në familje.

Janë mbajtur trajnime me OJQ-të: trajnim katër ditor me nga 27 pjesëmarrës me UNFPA-MSH-AMC, gjithësejt 108 profesionist shëndetësor nga regjioni i Republikës së Kosovës.

Trajnim katër ditor, 46 pjesëmarrës me UNDP-OBSH-MSH, me profesionist shëndetësor dhe mamit e vizitave shtëpiake nga regjioni i Republikës së Kosovës me temën: Socializmi gjinor dhe dinamikat gjinore, dhe roli i sistemit shëndetësor në reagimin ndaj dhunës së bazuar në gjini, të certifikuar nga Oda e Mjekëve.



Aktivitet i realizuar nga MSH

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë, gjatë 2019, ka punuar sipas detyrave të përcaktuara në këshilldhënie dhe monitorim të çështjeve të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore sipas LBGJ.ZBGJ ka qenë anëtare në komisione verifikuese në disa pozita të shpallura nga Ministria. Në kuadër të shënimit të 8 Marsit është organizuar takim me grupe nëpunës të ministries, ku moren pjesë edhe drejtues të stafit politik të kësaj ministrie, dhe diskutuan kërkesat, idetë e tyre në lidhje me punën dhe anancimin e grave në institucione.

Krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 numri i zyrtareve gra në MTI është rritur për 2%, duke u konsideruar progres në rritjen e numrit të grave në ministri për këtë vit 2019. Aktualisht të punësuar në MTI janë gjithsej 240 nëpunës. Prej tyre 154 ose 64 % janë të gra ndërsa 86 ose 36 % janë burra.

MTI gjegjësisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndermarrjeve në Kosovë (KIESA) ka organizuar panairë "Gratë në Biznes dhe artizanale tradicionale" në të cilat kanë marrë pjesë 32 biznese dhe shoqata të grave ndërmarrëse nga komunitete të ndryshme të Kosovës në Komunën e Gjilanit.

Në Parkun e Biznesit në Drenas janë nëntë përqind (9%) të grave ndërmarrëse.

Skema Voucher e Këshillëdhënies, Kuponi synon ofrimin e Këshillimeve të subvencionuara për NVM-të, me qëllim të ngritjes së performancës së përgjithshme të NVM-ve. Kuponi për këshillime mbështetë zhvillimin e ndërmarrjes duke ofruar shërbime të subvencionuara të këshillëdhënies, ku në fillim u japin të gjitha aplikantëve - grupe ndërmarrëse 10 pikë më shumë, si dhe të gjitha kërkesat e biznesit që paraqiten të ne dhe që kanë synim punësimin e grave që marrin 10 pikë më shumë. Vlen të theksohet se këtë vitë përmes Bankës Botërore janë duke i përkrahur edhe disa ndërmarrje në aspektin e këshillimit dhe certifikimit.

Grante për NMVM, - Synon ngritjen e kapaciteteve prodhuese. Qëllim është zvogëlimi i deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, të eksportit, konkurruesmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Subvencionim me mjete financiar për NVM-ve, për blerjen e makinerisë së re prodhuese gjatë vitit 2019 janë përkrahur :NTP "Shehu" Delfina Shehu, NTG "Blendi" Fatime Rama, Rami Plast Hava Hajdari. Po ashtu, në panairët e organizuara jashtë vendit është përkrahur, Shoqata e grave "Grat e Krushes", që është mbajtur në Zvicërr.



Aktivitet i realizuar nga MTI

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, duke u bazuar në planifikimin vjetor gjatë vitit, ka realizuar aktivitete të shumta në drejtim të barazisë gjinore në fushën e edukimit dhe arsimit. Në kuadër të shënimit të 11 Tetorit, Ditës Ndrekombëtare të Vajzave janë zhvilluar këto aktivitete: njoftim tek DKA që një orë mësimore ti kushtohet rëndësi dates së 11 Tetorit, MASHT nëpërmes ekspertëve të angazhuar ka mbajtur dy sesione informuese në komunën e Deçanit më dy SHFMU “Isa Boletini” dhe “Sylejman Vokshi”. Numri i pjesëmarrësve ishte 108 nxënës të klasave të teta dhe nënta. Qëllimi i kësaj dite është sensibilizimi i vajzave që të orientohen në karrier jo vetëm në profesione që tradicionalisht janë të evidentuara si profesione të vajzave por edhe për profesionet e ashtuquajtura tipike për burra. Në kuadër të shënimit të Javës për të Drejtat e Viktimave të Krimit janë zhvilluar këto aktivitete: Për shënimin e kësaj jave u njoftuan DKA- të që shkollat e tyre zhvillojnë aktivitete për rëndësinë që ka shënimin e kësaj jave. MASHT nëpërmes ekspertëve të angazhuar ka mbajtur dy sesione informuese në komunën e Prizrenit me mesimdhënësit e SHFMU “Lekë Dukagjini” (35 pjesëmarrës) dhe në komunën e Malishevës në SHFMU “P.N. Luarsini” me nxënës të klasave të nënta ku numri i tyre ishte 19 nxënës. Gjatë mbajtjes së sesionit në SHFMU “Lekë Dukagjini” prezent ishin përveç përfaqësueses së MASHT-it edhe përfaqes të prindërve, pedagog, psikolog, mesimdhënësit e Ed. Qytetare, Gj. Shqipe, Art figurative, Ed. Muzikore, Histori dhe mesues klasor. Në shënim të 16 Ditëve të Aktivizmit MASHT ka planifikuar aktivitetet që janë mbajtur në dy SHFMU “Hasan Prishtin” dhe “Sali Bytyqi” në komunën e Malishevës. Pjesëmarrës ishin nxënës të klasave të nënta dhe mesimdhënësit e shkollave përkatëse, të cilët u njoftuan me Procedurat Standarde të Veprimt për Mbrojtje nga Dhuna në Familje si dhe me kornizën ligjore që promovon barazinë gjinore.



Aktiviteti i realizuar nga MASHT

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal ka realizuar aktivitete të shumta gjatë vitit 2019 duke ikushtuar kujdes të veçantë aktiviteteve në fushën e barazisë gjinore, parandalimit të trafikimit me njerëz, ngritjen e kapaciteteve profesionale në përpunimin e plotë me dokumentet strategjike vendore dhe ato ndërkombëtare. MAPL sipas Strategjisë të Vetëqeverisjes Lokale 2016-2026, si dhe Planit Vjetor të Punës për vitin 2019, ka paraparë ti realizojë pesë objektiva, e njëra ndër to është Promovimi i të Drejtave të Njeriut dhe Ngritja e Kapaciteteve, ku hynë edhe barazia gjinore.

Për ti përkrahur politikat sektoriale me prioritet për vendin dhe si masë afirmative, për herë të parë kjo ministri ka krijuar një fond stimulues i veçantë për barazi gjinore me synim që të nxisim komunat për arritjen e barazisë gjinore si kategori e nën-përfaqësuar në sektorin publik. Me këtë rast, sipas rezultateve të performancës komunale në zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore janë ndarë 200.000.00 (dyqindmijëeuro) për komunat përfituese. Pra për performancë të mirë për arritjen e barazisë gjinore në pozita vendimmarrëse dhe zbatim të Ligjit Barazi Gjinore, këtë vit janë shpërblyer 4 komuna: Komuna e Kamenicës, Drenasit, Mitrovica e Veriut dhe komuna e Klllokotit.

MAPL në bashkëpunim me OSBE-në, kanë organizuar tryezë me temë përfaqësimi gjinor në nivelin lokal dy vjet pas zgjedhjeve lokale. Ministria Hodžić ka paraqitur të dhënat për dy vitet e kaluara që është regjistruar progresi në përfshirjen e grave në institucionet lokale, mirëpo ka theksuar ky parim nuk ka arritur nivelin e duhur. Pra, është e domosdoshme që të zbatohen plotësisht të gjitha ligjet dhe mekanizmat institucionale në luftën kundër diskriminimit dhe marginalizimit të grave në të gjitha sferat e jetës dhe proceset që ndodhin në shoqërinë Kosovare.

Në 38 komunat e RKS, të gjitha udhëhiqen nga burrat. Nga 38 kryesues të kuvendeve të komunave, 32 janë burra, ndërsa 6 janë gra. Ndërsa drejtorët e drejtorive në komuna janë gjithsejtë 352 drejtorë, nga ky numër prej tyre 85 drejtori udhëhiqen nga grat, 267 udhëhiqen nga burrat, për 37 komuna (mungon komuna Zubin Potok). Kjo tregon se këtë vit ka ndryshime, nga 18% sa ka qenë përfaqësimi në vitin 2018, tash është 22.16%, që do të thotë, pas masave të ndërmarra nga MAPL ka avancim të pozitës së femrës në vendimmarrje nga viti i kaluar për 3.43%. Nga gjithsejtë 38 nënkryetar/e, 2 janë gra (Suhareka dhe Zubin Potok) ndërsa 36 janë burra.

Komuna e Drenasit, Kamenicës, Klllokotit, Mitrovica e veriut, Prishtinës, Junikut, Obiliqit, janë shembull më i mirë i respektimit të Ligjit për Barazi Gjinore, pasi kanë të emëruar gratë në 50% në vendimmarrje, përderisa në komunat me popullsi dhe administratë më të madhe nuk respektohet Ligji për BGJ, si në komunën e Gjakovës, Prizrenit, Podujevës, Mitrovica e Jugut, Fushë Kosovës, Malishevës, Graçanicës, Suharekës, Vushtrrisë. Ndërsa ato komuna që janë me 0% është komuna e Shterpcës, Ranillugut, Mamushës dhe Dragashit.

MAPL në bashkëpunim me ABGJ kanë dërguar shkresë zyrtare të gjitha komunave të RKS, ku është kërkuar që *“Organet komunale janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave”*. Pas kërkesës për respektimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore për përfaqësim të barabartë gjinor, respektivisht krijimit të hapësirave dhe kushteve për rritjen e numrit të përfaqësimit të gruas në organet ekzekutive dhe trupat e kuvendit të komunës MAPL është kujdesur që nëpërmes mekanizimit ligjor të shqyrtimit administrativ të mos konfirmohet ligjshmëria e asnjë vendimi të komunave të cilët nuk përbëjnë përfaqësim të duhur për të dy gjinitë në komitetet e përhershme të kuvendeve të komunave, atë për Politike dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete. Në këtë proces MAPL ka kthyer të gjitha ato vendime që nuk kanë përmbushur këtë standard, duke kërkuar rishqyrtimin e vendimit përkatës dhe ndryshimin e tij në atë mënyrë që të sigurohet përfaqësim i duhur në këto komitete për të dy gjinitë.

Numri total i shërbyesve civil në MAPL është 126, nga ky numër 63 janë gra dhe 63 janë burra. Në nivelin menaxherial, përveç Sekretares së Përgjithshme, nga pesë (5) departamentet janë përzgjedhur dy (2) drejtoresha, ndërsa në tri (3) departamentet tjera udhëhiqen nga burrat. Po ashtu, në nivelin e udhëheqësve të divizioneve nga 19 Divizione sa ka gjithsej MAPL, dhjetë (10) prej tyre udhëhiqen nga udhëheqëse gra dhe nëntë (9) Divizione nga udhëheqës burra. MAPL është fokusuar në zbatimin e ligjit për barazi gjinore dhe përfaqësimin e barabartë në pozitat e shërbimit civil. Përfaqësimi gjinor në MAPL është arritur 50% në të gjitha nivelet.



Aktivitet i realizuar nga MAPL

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit ka realizuar aktivitete konformë planit dhe strategjisë së parparë për vitin 2019. ZBGJ ka monitoruar dhe ka qenë anëtare në komisione dhe vendimete ndryshme për arritjen sa me të mirë të standardeve që promovojnë barazinë gjinore në MIT-it. Me rastin e shënimit 8 Marsit, është organizuar trajnim një ditorë me temë: *“Buxhetimi i Përgjithshëm Gjinor”* në të cilën morën pjesë zyrtaret e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit. Sipas raportit të dërguar nga ZBGJ në MIT gjithësejtë janë 135 qendra të kontrollit teknik të automjeteve në Kosovë, prej tyre 129 janë në pronesi të burrave dhe 6 janë gra.

Numri i përgjithshëm sa i përket patent shoferës nga pjesa teorike kategoria “B”, të ndara sipas gjinisë për periudhën e vitit 2019, janë gjithsej kandidat të testuar: 62,453, prej tyre 18,841 ose 56% burra kaluan testin, ndërsa gra 14,387 ose 44%

2019	Gjithsej	Burra	% M	Gra	% F
Autoshkolla	265	206	77.74	59	22.26
Pyetës teorik	48	43	89.58	5	10.42
Pyetës të drejtimit	4	3	75.00	1	25.00
Instruktor shofer	261	197	75.48	64	24.52
Ligjerues profesional ne A.SH	136	120	88.24	16	11.76

Raporti i Departamenti të automjeteve të MIT-it për vitin 2019 numrin e përgjithshëm të autoshkollave të licencuara nga MIT-it, të cilët janë në pronsi të grave dhe burrave, numrin e pyetësve të drejtimit, pyetësve teorik, instruktore shofera/ve, ligjëruesve profesional në autoshkolla

MIT ka gjithsejtë 11 gra në pozita drejtuese, ndërsa sa i përket të punësuarve janë gjithsejtë 288, prej tyre 74 ose 26% gra, ndërsa 214 ose 74% burra.



Aktivitet i realizuar nga MIT

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka raportuar për aktivitetet e ndërmarra për vitin 2019. Aktivitete e ZBGJ janë ndërmarr në bashkëpunim me konsulentët e projektit të Sides dhe stafin e MMPH duke bërë që të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore të përfshihet në çdo faze të procesit dhe planifikimit, miratimit, zbatimit, politikave dhe programeve si dhe buxhetit të kësaj ministrie. Krahas kësaj janë organizuar dy punëtori dhe takime për Hartimin e dokumentit Drejtimet strategjike dhe Planet e Veprimit për Barazi Gjinore në MMPH, ku kanë marrë pjesë 20 zyrtar të ministries prej tyre 14 gra dhe 6 burra.

Për nder të shënimit të 8 Marsit është organizuar tryezë diskutimi me temë “Integrimi dhe Buxhetimi Gjinor në hartimin dhe Zbatimin e Politikave të ministries. Ndërsa gjatë fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit është mbajtur trajnimi “Dhuna në baza gjinore dhe ndikimi i gjinisë në mjedis”. Pjesëmarrës në këtë trajnim dy ditë ishin 17 persona, 12 gra dhe 5 burra. Ky aktivitet u mbështet nga Sida.

Në kuadër të projektit “Programi Mjedisor i Kosovës 2016-2020” që është realizuar në MMPH në partneritet me FCG, NCG dhe EPTISA dhe mbështetur nga Sida është realizuar një pyetësor për stafin e ministries me temë “Vlerësimi i nevojave për trajnime gjinore në MMPH”, duke u bazuar në komponentën e nëntë të projektit ku përfshihet barazia gjinore. Po ashtu, ZBGJ ka mbajtur trajnim “Dallimet/ Seksi dhe gjinia, rolet gjinore, normat, stereotipet gjinore”

Po ashtu ZBGJ ka qenë pjesë e grupit në hartimin e koncept dokumenteve të ndërmarra nga MMPH



Aktivitet i realizuar nga MMPH

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, gjatë vitit 2019 ka monitoruar zyrat kadastrale për zbatimin e Udhëzimit Administrativ me Nr. 02/2019 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme të Përbashkët në emër të dy Bashkëshortëve i cili ka për qëllim që bashkëshortet të cilët e regjistrojnë pronën e përbashkët të lirohen nga taksa fillestare (nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 për tarifat e shërbimeve regjistrimin e të drejtave të pronës së paluajtshme) në zyrat kadastrale komunale;

Statistikat e pronarëve në bazë gjinore në nivel vendi janë 441,125 (80,58 %) burra dhe 95,457 (17,44 %) gra. Që nga hyrja në fuqi e masës afirmative 2016-2019 kanë përfituar 5392 bashkëshortë.

Sa i përket të punësuarve në AKK janë gjithsejtë 52 të punësuar, prej tyre 33 burra dhe 19 gra. Ndërsa në nivel drejtues janë 6 burra dhe 5 gra, marr parasyshë këtë shifer shihet që AKK ka arrite te këtë barazi gjinore në nivel drejtues.

Ndryshe, në kuadër të shënimit të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizimit ZBGJ ka përgatit një broshur me qëllim të informimit të qytetarëve për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve



Aktiviteti i realizuar nga AKK

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, ka raportuar për statistikën sa i përket përfaqësimit gjinor në MZHE, duke përfshirë edhe agjencitë që janë në kuadër të kësaj ministrie. Aktualisht, MZHE ka 150 shërbyes civil, prej të cilëve 60 janë gra dhe 90 burra. Kurse, për sa i takon stafit politik në MZHE numri i përgjithshëm është 27, prej të cilëve 9 gra dhe 18 burra. Struktura gjinore në Agjencionin për Eficiencë të Energjisë është 4 gra dhe 3 burra. Agjencioni i Kosovës për Eficiencë gjatë vitit 2019 ka kontribuar në avancimin e gruas në Kosovë, në kuadër të Projektit Millenniumkosovo MCC për eficiencë të energjisë AKEE-ja ka qenë institucioni kyç në hartimin e termave të referencës, ku është propozuar që në sektor të energjisë të ngritën kapacitetet për gruan. Me këtë rast kanë përfituar 28 gra bursa për studime në sektor të energjisë në SHBA.

Ndryshe, ZBGJ është pjesë edhe e Shoqatës së Grave në Sektorin e Energjisë, e cila u lansua në vitin 2017 me mbështetjen e projektit të USAID, REPOWER-KOSOVO dhe është organizata e parë dhe e vetme e shoqërisë civile në Kosovë që fokusohet në gjininë në sektorin e energjisë. Institucionet partnere që mbështetën iniciativën përfshinin: Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), Zyren e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Deri më tani, AWESK ka rreth 140 anëtare, profesionistë të trajnuar dhe të arsimuar nga një gamë e gjerë profilesh, duke përfshirë: gra inxhinierë, ekspertë ligjorë, administratorë dhe BNJ, TI, personel marketing dhe PR dhe akademikë nga inxhinieri dhe shkencat shoqërore.

Qëllimi i krijimit të AWESK është të avancojë diversitetin gjinor përmes mentorimit, rrjetëzimit, zhvillimit të aftësive dhe vetë-menaxhimit të karrierës. Ai synon të ndihmojë institucionet të identifikojnë veprime konkrete dhe të zbatueshme që do të fuqizojnë gratë në industrinë e energjisë për vlerën dhe zhvillimin profesional.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Ministrinë e Kulturës, Rinis dhe Sportit, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas ka marrë pjesë në formimin e iniciativës së bashkëpunimit për projekte të ndryshme me grave në Kosovë dhe Britani. Pas diskutimit mbi të arriturat por edhe sfidat e shumta për gruan në Kosovë, në arsim, punësim, vendimmarrje etj, lindi dhe iniciativa për një organizim formal të grave të diasporës në Britaninë e Madhe. Ky aktivitet u realizua në bashkëpunim me Ambasadën e Kosovës në Britaninë e Madhe.

Duke folur për kontributin e grave shqiptare në diasporë, ku pjesë e diskutimit ishte ZBGJ e cila tha se duhet të angazhohemi më shumë se deri tash për edukimin, promovimin dhe ndërgjegjësimin qytetar - me qëllim të nxitjes së ndjenjës së identitetit kulturor dhe si burim i frymëzimit dhe inovimit. Si pjesë e rëndësishme e procesit të mbrojtjes, njëherit sfidë e veçantë për Kosovën, mbetet edukimi i gjeneratave të reja mbi trashëgiminë kulturore dhe ndërgjegjësimin qytetar, si dhe promovimin dhe rritjen e dukshmërisë së potencialit të vlerave të trashëgimisë kulturore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

ZBGJ po ashtu gjatë viti 2019 ka publikuar një shkrim në gazetën Kosova Sot, rreth pushimit të lehonisë, me titull "Nënat detyrohen të zgjedhin mes punës dhe Fëmijës".



Aktivitet i realizuar nga MKRS

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Qendrën e Studentëve, bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, gjatë vitit ka mbajtur diskutime me stafin e qendrës se studenteve për zbatimin e LBGJ. Po ashtu gjatë vitit ka realizuar vizita në konvikte, ku nga 8 konvikte sa janë gjithsejtë 5 prej tyre janë gra ndërsa 3 burra.

Te dhënat sa i përket stafit në QS janë 239 gjithsejtë, prej tyre 75 gra dhe 164 burra, në pozita vendim-marrëse janë 3 gra dhe 14 burra. Ndërsa, student janë 1504 burra dhe 2362 gra.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Dragashit, ka ndërmarr aktivitete duke u bazuar në objektivat që i ka planifikuar gjatë vitit, për zbatim, monitorim dhe raportim mbi zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar mbi promovimin dhe përhapjen e vlerave në fushën e të drejtave të njeriut e në veqanti të gruas. Me rastin e shënimit të 8 Marsit – ditës së gruas është realizuar një debat ku të pranishëm kanë qenë të gjitha gratë e punësuar si : gratë në administratës , QKMF-së, Arsimit, Asmblesë dhe familjare të dëshmoreve dhe mysafir ishin përveç Kryetarit të Komunës, drejtorit të arsimit dhe të shëndetësisë edhe kryetarja e komsionit paramentar për të drejtat e njeiut dhe barazi gjinore z.Duda Balje, ku u diskutua nevojën e funksionalizimit të çerdhes së fëmijëve, (që është komuna e vetme pa çerdhe publike), funksionalizimi i repartit të gjinokologjisë, ikuadrimi i një mjeke – grua , në QKMF- së në Dragash dhe gruaja në vendimarrje që ende vazhdon të mbetet temë tabu në Komunën e Dragashit.

Në bashkëpunim me policin janë realizuara seseione informues me të gjithë nxënësit e klasëve të IX -ta, në komunën rreth abuzimit seksual të fëmijëve. Janë mbajtur takime me gra për LBGJ dhe dhunën në Familje, ku moren pjesë 20 pjesësmarrese gra të ndryshme anise, punëtore të sektoreve të ndryshme -takim është përkrahur nga UNËOMEN. Gjatë fushatës 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës në familje është realizuar një debat me përfaqësues nga stuktura udhëhëse të komunës dhe të institucioneve të ndryshme si dhe antarë të mekanizmit, po ashtu mbas debatit realizuam Marshit, në shesh të Dragashit me moton “Familje e shëndosh -Shoqëri e shëndosh “.Debati dhe marshi u relaziun në praninë e mediav lokale,RadioSharrit, TV-Opojës si dhe nga televizioni publik, RTK dhe moren pjesë afër 1000 persona nxënëse, mësime dhënëse, përfaqësues institucioneve antarë të M.K dhe qytetar të ndryshëm.

Po ashtu, janë realizuar disa takime me KDI nëpër fshatra të ndryshme, duke bërë përpjekje që gratë dhe vajzat të janë të pranishme në takim për buxhetin komunal. Shënimi i Ditës së ndërmarrjes së grave është organizuar me 15 nëntor me disa gra fermere të komunës së Dragashit dhe Komunës së Vitisë, në mbështetje nga programi i agro-bujqësisë, të UNDP dhe ADA -së.



Aktiviteti i realizuar nga Komuna e Dragashit

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit, bazuar në detyrat dhe përgjegjësit gjatë vitit 2019 ka realizuar një serë aktiviteteve për promovimin dhe avancimin e barazisë gjinore në vend. Me rastin e vazhdimin të masës afirmative për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve ZBGJ ka shpërndarë poster ne hyrje të komunës, më qëllim që qytetarët të jenë të informuar. Gjatë vitit 2019 në Drejtorinë për Gjeodozi, Kadastër dhe Pronë si rezultat i vazhdimin të masës afirmative janë paraqitur 32 kërkesa për regjistrimin e pronës në emër të të dy bashkëshortëve, ndërsa gjithsej nga viti 2019 janë 99 raste ku grat në çfarëdo forme janë përfshirë në lidhje me pronën qoftë bartje, regjistrim pronësise në emër të grave, trashëgim etj.

ZBGJ në bashkëpunim me QPDG me Drejtoreshen Kadire Tahiraj dhe QKMF radiologun Shkelzen Gashi është mbajtur një sesion informues lidhur me kancerin e gjirit. Në këtë sesion informues përveq zyrtarëve nga Komuna kanë marrë pjesë edhe shoqëria civile. Numri i pjesëmarrësve ka qenë 47 gra.

Në kuadër të fushatës së 25 Nëntorit Ditës Ndërkombëtare për Eliminim e Dhunës ndaj Gruas, janë realizuar disa poster dhe fletushka të cilët janë shpërndarë në institucionet komunale si dhe tek qytetarët me mesazhin për parandalimin e dhunës në familje, si dhe për legjislacionin i cili rregullon dhunën në familje si dhe institucionet ku mund të kërkojnë ndihmë nëse janë viktimat të dhunës në familje. Po ashtu është mbajtur edhe një takim në Qendrën për Punë Sociale, lidhur me ndihmën të cilën e ofrojnë ata për viktimat e dhunës në Familje, me cilat vështirësi dhe sfida përballen gjatë punës së tyre në trajtimin e viktimave.

ZBGJ ka mbajtur takim me ekipin e OSBE-së, lidhur me pyetësorin “Monitorimi i Ligjit për Barazinë Gjinore”. Gjatë këtij takimi është diskutuar për Strategjitë dhe planet e veprimit të cilat i zbaton Komuna për të promovuar Barazinë Gjinore, sigurimin e integritetit gjinor të politikave, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, përbërjen gjinore të Kuvendit Komunal, përbërja gjinore e Komitetit të Komuniteteve etj.

Drejtoria Komunale e Arsimit gjatë vitit 2019 ka ndarë 40 bursa për nx. të shkollave të mesme dhe 160 të tjera për student të univeristetit, prej tyre 127 bursa për gra dhe 33 për burra. Studentët përfitues të bursës komunale për vitin akademik 2019/2020 kanë nënshkruar kontratat për marrjen e bursës të ndara nga Komuna në vlerë prej 500 € për një student.

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me AZHR-në ka mbajtur trajnimin “Fuqizimi i të rinjve dhe grave në aftësi të buta dhe aftësi menaxheriale”. Në këtë trajnim pjesëmarrësit janë trajnuar në mënyrë profesionale rreth aftësive të buta dhe atyre menaxheriale. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë Kryetari i Komunës, Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Gratë nga Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave, të rinjtë nga Qendra Rinore, nga Zyra e Entit të Punësimit dhe qytetarë. Përfitues të këtij trajnimit kanë qenë 27 persona, prej tyre 17 kanë qenë gra dhe 10 burra.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka përkrahur me 100 multikultivator fermeret e komunës, prej tyre 11 janë gra, ndërsa me Serra janë përkrahur 93 fermerë, prej tyre 24 përfituese kanë qenë gra dhe 69 burra.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport gjatë viti 2019 ka mbështetur me subvencione OJQ “Bliri” për realizimin e aktiviteteve. Ku përfituesja ka realizuar panair dy ditor për promovimin e produkteve tradicionale. Qëllimi i këtij panairi ka qenë fuqizimi ekonomik i grave në biznese, artizanale tradicionale përpunimin e pemëve dhe perimeve, kultivimin e mjaltit dhe përpunimi i drurit.

Komuna e Drenasit është njëra ndër komunat me përfaqësim të barabart gjinor, ku nga gjithsejtë 12 drejtori, 6 udhëhiqen nga gratë, si dhe pjesa dërrmuese e stafit të administratës komunale janë gra.



Aktivitet i realizuar nga Komuna e Drenasit

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Vitisë, gjatë vitit 2019 ka zhvilluar aktivitete te shumta në fuqizimin dhe rolin e gruas. Janë mbajtur dy trajnime me zyrtar komunal, OJQ, këshilltar të kuven-dit për implementimin e ligjeve të aplikueshme në funksion të barazisë gjinore, ku përfitues nga këto trajnime janë 30 pjesëmarrës (zyrtarë komunal nga sektorë të ndryshëm dhe këshilltarë komunal). Në bashkëpunim me KDI është organizuar tryezë për pjesëmarrjen e grave në takimet publike, ku morën pjesë 25 persona, prej tyre kishte nga drejtoritë, këshilltarë komunalë, pjesëtarë nga shoqëria civile, organizatat e të rinjëve.

ZBGJ ka bërë analizën gjinore dhe përgatitja e buxhetimit gjinor në kategoritë ekonomike: paga mëditje, subvencione si dhe investime kapitale, ku janë dhënë rekomandime të reja për të eliminuar pabarazitë gjinore në këto tri kategori ekonomike, e të cilat rekomandime janë inkuorporuar në buxhetin e vitit 2020.

Po ashtu, është përgatitur dhe shpërndarë fletushka “Njih të Drejtat”, ku janë dhënë informacione për të drejtat në trashëgimi dhe pronë, konform ligjeve në fuqi.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Qendren për punë sociale si dhe ekipin veprues për siguri në bashkësi është mbajtur ligjërata në shkollat e komunës së Vitisë për parandalimin e ngacmimeve seksuale, keqpërdorimin e rrjeteve sociale, trafikimit me qenie njerëzore, parandalimit të dhunës në familje, ku përfitues nga këto ligjërata ishin 1400 nxënës të shkollave të mesme të ulta të Komunës së Vitisë.

Shënimi i Javës së Grave ndërmarrëse është mbajtur përmes së një tryeze diskutimi me institucionet komunale, bizneset aktive të grave që veprojnë në Komunën e Vitisë, dhe u organizua në bashkëpunim me UNDP dhe kishte për qëllim gjetjen e modaliteteve për krijimin e lehtësirave për zhvillimin e bizneseve që udhëheqën nga gratë. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur dy panaire me moton “T’i njohim vlerat tradicionale”, ku gratë ndërmarrëse në këto panaire kanë pasur mundësi t’i ekspozojnë produktet e bizneseve të tyre.

Ndër aktivitetet e tjera është edhe fushata “Java për Barazi” ku në kuadër të kësaj fushate janë organizuar aktivitete të ndryshme nëpër të gjitha shkollat e komunës së Vitisë, si ekspozita, ligjërata, bashkëbisedim nxënës mësimdhënës, e aktivitete tjera. Në bashkëpunim me organizatën “Gratë për Gratë” dhe Ambasadën Amerikane është organizuar një takim ku është bërë lansimi i projektit 1 (një) vjeçar “Aftësimi profesional për punësim” me fokus viktimat e dhunës, pjesëmarrës ishin 50 gra.

Në komunën e Vitisë është themeluar Mekanizmi koordine Kundër dhunës në Familje, që ka për synim parandalimin e dhunës në familje, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të dhunës në familje dhe pjesë përbërëse e këtij mekanizmi janë 15 institucione relevante që merren me këtë çështje. Fushata e 16 Ditëve të Aktivizmit është zhvilluar me aktivitete te shumta si: ligjërata nëpër shkollat me nxënës, shpërndarje e fletëpalosjeve dhe e posterëve në lokalitetet të ndryshme.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Malishevës, gjatë vitit ka mbajtur takime, ligjerata si dhe aktivitete te shumta në zbatim të planit të punës. Në fillim të vitit është realizuar takim me grupin e grave, komunitetin për barazi gjinore dhe OJQ-të aktive në komunë, ku janë paraqitur objektivat kryesore për planifikimin e punës për vitin 2019. Java e marsit ka qenë e përfshirë me aktivitete të ndryshme, vizita familjeve të dëshmorëve (nëntë familje), hapja e ekspozitës me gra të shquara shqipëtare ndër vite, vizitë shoqatës për promovimin e të drejtave të grave në Drenas dhe ndarja e mirënjohjeve për gra të suksesshme, duke përfshirë, kontributin e dhënë në arsimim dhe emancipim, familje të dëshmorëve, post mortum, kontributin e dhënë gjatë luftës, dhe biznes.

Po ashtu janë mbajtur takimet me grupin e grave dhe komitetin për barazi gjinore ku është diskutuar rreth formimit të mekanizmave koordinues kundër dhunës në familje, dhe kjo është përcjellur me disa rekomandime. Vlenë të përmendet se është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit për formimin e mekanizmave koordinues kundër dhunës në familje në Komunën e Malishevës (në bashkëpunim me OSBE). Pas formimit të MKDHF, ky mekanizëm ka mbajtur takim me drejtoreshën e strehimores “shtëpia e sigurtë” për ndihmë dhe përkrahje nga ana e komunës, bashkëpunimin me institucionet që trajtojnë rastet e dhunës në familje.

Në bashkëpunim me ekipet vepruese për siguri në bashkësi realizuam tryezën për dhunën në familje dhe përfshirjen e të gjitha shkollave me ligjërata me temën e njejtë, të cilat përfunduan në muajin tetor. Në bashkëpunim me QPDG – Drenas, organizuam në Malishevë tryezën të mbijetuarat

e dhunës seksuale, dhe rekomanduar që takime të tilla të realizohen edhe në disa zona rurale të komunës tonë.

Sa i përket 16 Ditëve të Aktivizimit u relizuan tri ligjërata në dy shkolla të mesme dhe një fillore, në bashkëpunim me policinë, pas ligjërates nxënësit patën rast t'i përgjigjen disa pyetjeve të parashtruara në pyetësorë, me ç'rast nga përgjigjet e tyre rezultoi se ata kanë njohuri lidhur me dhunën në familje, dinë ku të drejtohen nëse dhuna është e pranishme.

Në vazhdim u mbajt tryeza për dhunën në familje përkatësisht eliminimin e dhunës ndaj grave, të pranishëm ishin akterët e mekanizmit koordinues, ku u parashtrua roli i policisë, ZBGJ, QPS, strehimores në raport me viktimat e dhunës, ndër të tjera u diskutua edhe për objektivat e përcaktuara në kuadër të mekanizmit :në parandalim dhe vetëdijësim, mbrojtje dhe koordinim dhe rehabilitim dhe ri-integrim.

Të dhënat statistikore në baza gjinore

Prej 11 drejtorive e emëruar është një drejtoreshë (DKRS) dhe 3 menaxhere të sektorëve. Prej 41 shkollave dhe dy paraleve janë 9 drejtoresha. Janë të regjistruara gjithësejt 140 biznese – 22 gra dhe 118 burra. Në asistencë sociale janë gjithësejt 720.

Të punësuar në Administratën Komunale janë 146 gra dhe 146 burra, Arsime 345 gra dhe 586 burra, Shëndetësi 59 gra dhe 61 burra.



Aktivitet i realizuar nga Komuna e Malishevës

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Gjakovës, bazuar në planin e punës, promovimin e plotë të drejtave të njeriut, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të komuniteteve ka realizuar disa aktivitete gjatë 2019.

Me iniciativën e ZBGJ, dhe në mbështetje të Komunës së Gjakovës dhe me mbështetje të zyrës së Un. Eomen në Kosovë, është organizuar Konferenca Rajonale me temën: “Sfidat dhe të arriturat e gruas shqiptare në periudhën e pas luftës”. Në këtë konferencë morën pjesë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Lugina e Preshevës. Punimet për Konferencën Rajonale të Gruas, janë organizuar në katër panele, me tema të llojllojshme që i përkasin sfidave dhe të arriturve të gruas shqiptare në periudhën 20 vjeçare pas luftës së fundit në Kosovë.

ZBGJ ka mbajt 6 takime me Grupin e Grave Asambleiste dhe 10 takim me OJQ lokale me qëllim të përkrahjes dhe avancimit të gruas në të gjitha sferat si shoqërore ashtu edhe politike. Organizimi i tryezës së rrumbullakët për promovimin e barazisë gjinore në nivel lokal me temën „ Barazia gjinore në nivel komunal- buxheti i përgjithshëm gjinor. Ky aktivitet u realizu me qëllim të diskutimit dhe bashkërendimit të aktiviteteve në fushën e barazisë gjinore, në qeverisjen lokale. Janë organizuar pesë (5) takime me anëtarët e mekanizmit kundër dhunës në familje. Qëllimi i takimeve raportimi i institucioneve relevante mbi koordinimin dhe procesimin e rasteve të dhunës në familje. Duke iu referuar të dhënave nga stacioni policor i Gjakovës për periudhën janar-qershor është në

rritje rastet e dhunës në familje ne krahasim nga viti i kaluar. Numri i rasteve të dhunës në familje të raportuara është 65 raste.

Sa i përket masës afirmative për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve në komunë e Gjakovës deri në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 janë 355 gjithsejtë.

Në kuadër të shënimit të fushatës ndërkombëtare kundër kancerit të gjirit, ZBGJ në bashkëpunim me drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka organizuar fushatën një mujore mbi edukimin shëndetësor – riprodhues të grave, nëpër të gjitha qendrat e Mjekësisë Familjare. Ndërsa, me rastin e shënimit të muaj antitrafikim janë organizuar disa aktivitete, ku njera ndër to është edhe mbajtja e një tryeze të rrumbullaktë “Parakalimi i trafikimit me qenie njerëzore”. Qëllimi i kësaj tryeze ishte promovimi i dialogut ndërmjet aktereve përkatës dhe shoqërisë civile mbi fenomenin e trafikimit me qenie njerëzore dhe angazhimit të institucioneve përkatës, dhe ndërgjegjësimi i nxënësve për pasojat dhe rreziqet e trafikimit me qenie njerëzore.

Te pranishëm kanë qenë përfaqësues nga Prokuroria, Avokati për mbrojtje të viktimave, Zyrtarja për barazi gjinore, Drejtori i Qendrës për Punë Sociale, Komandanti i Policisë, Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, përfaqësuesit e shkollës, mësuesit, studentët dhe prindërit, si dhe përfaqësuesit e OJQ-ve.

Hapja e fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit është mbajtur marsh me moton “Gjenerata e Barazisë Ngritën Kundër Dhunës Seksuale”. Ecja ka filluar nga objekti aktual i Komunës së Gjakovës (ish Bankos) dhe ka vazhduar me ecje deri tek “Çarshia e Vogël”. Po ashtu është bërë ndiçimi i objektit të Komunës me ngjyrë portokalli, si dhe janë mbajtur edhe disa takime me Mekanizmin kordinues kundër dhunës në Familje, me drejtoritë për administratë të përgjithshme, drejtorat e shkollave fillore dhe të mesme, zyra për komunitete, drejtoritë për shëndetësi, qendrën për punë sociale, gjykatës themelore, prokuror të shtetit, Policë, mbrojtësit të viktimave, spitale rajonal “Isa Grezda”, zyra për ndihma juridike falas.

Janë organizuar 18 takime senzibilizuese në qytet dhe në viset rurale, me qëllim të ndërgjegjësimit të komunitetit, bazuar edhe në planifikimin e bërë në Planin Strategjik të Komunës, si dhe takime informuese me nxënës të shkollave.

Duke iu referuar të dhënave statistikore nga stacionin policor në Gjakovë kanë raportuar 125 raste të dhunës në baza gjinore për periudhën kohore janar-dhjetor 2019.



Aktivitet i realizuar nga Komuna e Gjakovës

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë Kosovës, me qëllim të promovimit të barazisë gjinore janë rearlizuara disa aktivitete me grupe të ndryshme të interesit, si takime me organizatat e shoqërisë civile, komunitetin e të rinjëve, grupe etj. Gjatë kësaj kohe ka organizuar trajnimin dy ditor me një grup të nënave për t'i njohur me afër me temën: "Zhvillimi i fëmijëve dhe faktorët e rrezikut që mund të ndikojnë në paraqitjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit" në bashkëpunim me organizatën IOM.

Promovimi i vlerave tradicionale të produkteve ushqimore, me rastin e festave të marsit janë organizuar panairë tre ditore me gratë për promovimin e produkteve ushqimore dhe punë dore. Në kuadër të aktiviteteve të marsit në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të komunës është folur për Ditën Ndërkombëtare të Grave – 8 Marsin, duke e cilësuar dhe duke e ngritur këtë aktivitet si Javë të Barazisë Gjinore, me qëllim të promovimit të Ligjit për Barazi gjinore Neni 21- Edukimi për Barazi Gjinore. Po ashtu është mbajtur tryezë me temë -Pozita e femrës në Komunën tonë në bashkëpunim me grupin e grave asamblistë. Si komponentë tjetër dhe prioritet ka qenë Fuqizimi i rolit të gruas në shoqëri, me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së grave në takimet publike dhe proceset vendimarrëse, ka qenë projekti i cili është organizuar me gratë, vajzat e të gjitha komuniteteve për t'i inkurajuar femrat që sa më shumë të marrin pjesë në takimet publike në mënyrë që të merren parasysh edhe kërkesat e tyre qoftë për projekte investive apo çështje tjera ka qenë qëllimi i projektit që është realizuar në muajin qershor - korrik

Fushatë promovuese për Legjislacionin në fuqi ka qenë fushata për Ligjin e trashëgimisë dhe Ligjin për Barazi Gjinore, ku është realizuar në muajin shtator, janë shpërndarë 200 fletëpalosje për të drejtat e grave në trashëgimi, 200 fletëpalosje për Ligjin për Barazi Gjinore. Panairi dy ditorë me ushqime tradicionale me gratë me rastin e ditëve të Diasporës, në bashkëpunim me organizatën e gruas "Flori."

Me qëllim të vetëdijesimit të grave për kancerin e gjirit janë organizuar trajnime me gratë gjatë muajit tetor ku janë shpërndarë, 200 fletëpalosje 10 postera.



Aktivitet i realizuar nga Komuna e Fushë Kosovës

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Skenderajt, nisur nga planet e punes në bashkëpunim me Gratë Asambleiste ka mbajtur takim të rregullta me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore dhe fuqizimin e rolit të gruas. Në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) më rastin e festës së 8 Marsit është organizuar takimin: Adresimi i stigmes për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Pjesëmarrës në takim ishin 31 F dhe 8 M. ZBGJ në bashkëpunim me anëtarët e kuvendit Komunal është vizituar Strehimorja “Raba Voca” në Mitrovicë ku u njoftuan me sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohet kjo strehimore. Nga ky takim Komuna e ka mbështetur më mjete financiare në vlerë (2500 €) Strehimoren “Raba Voca” në Mitrovicë. Në shtëpinë e kulturës “Hasan Prishtina” në Skenderaj është mbajtur shfaqja “Stigma –kërko të drejtën tënde” e cila është organizuar në bashkëpunim me organizatën jo-qeveritare Artpolis –Qendra për Art dhe Komunitet dhe e cila ka pasur për qëllim ngritjen e vetëdijes mbi stigmatizimin, të drejtat e njeriut, adresimin e çështjeve dhe problemeve të ndryshme sociale. Pjesëmarrës në këtë shfaqje kanë qenë nxënësit e shkollave të mesme –cikli i lartë, të rinjtë, shoqëria civile, gratë dhe burrat.

Në bashkëpunim me OSBE u organizua punëtorja për qasjen e Grave në të Drejtat Pronësore dhe të Trashëgimisë për Organizatat Joqeveritare dhe Gratë nga Zonat Rurale, dhe u diskutua për të drejtat e grave në pronë, sfidat lidhur me zbatimin e legjislacionit dhe me normat ekzistuese sociale dhe kulturore që pengojnë qasjen e barabartë në të drejtat pronësore dhe të trashëgimisë. Pjesëmarrëse ishin 37 femra dhe 6 meshkuj.

Komuna e Skenderajt në bashkëpunim me bizneset i ka ndarë 164 bursa për student, kane përfituar 99 Vajza dhe 65 Djem. Nga 57 vende pune të shpallura nga Drejtoria e Arsimit 40 nga to kanë qenë gra. Në ditën e hapjes është vendosur Kordelja e bardhë nga të gjithë zyrtarët komunal e cila tregon zotimin e tyre për të mos e heshtur problemin e dhunës ndaj grave, janë shpërndarë broshura dhe janë vendosur postera të cilët kanë përçuar mesazhin se dhuna ndaj grave është shkelje e të drejtave të njeriut, po ashtu janë mbajtur ligjërata me temën “Dhuna në Baza Gjinore” në dy shkolla me nxënësit e kl. të IX-ta

Sipas shënimeve të marrura nga stacioni policor në Skenderaj rezulton se numri i rasteve të Dhunës në Familje të raportuara është 26 raste.



Aktivitet i relaizuar nga Komuna e Skenderajt

Zyrtari për Barazi Gjinore në Komunën e Rahovecit, duke u bazuar në disa objektiva që i ka planifikuar për realizim të aktiviteteve gjatë gjithë vitit, ka monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar në institucionet komunale

Në shënimin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas me një grup të grave të punësuar në institucione, dhe me familjarë të dëshmorëve ka realizuar një vizitë në fabrikën e grave të Krushës në fshatin Krushë e madhe të Rahovecit. Janë realizuar disa aktivitete që kanë pasur për qëllim promovimi e trashëgimise dhe pronës së gruas, medisa gra, vajza dhe me nxënës të shkollës së mesme në bashëpunim me OSBE.

ZBGJ ka mbajt disa takim dhe tyreza të ndryshme me qëllim të fuqizimit të gruas dhe levizjes para dhe për funksionalizimi të çerdhës, si takimi me Kryetarin dhe me asamblesitet e Komunës me akter të ndryshmu komunal. Ku si rezultatështë arritur që të fillojnë punimet për ndërtimin e çerdhes në fshatin Ratkoc, Xërxe, Krushe e Madhe.

Gjatë muajit tetor me qëllim të senzibilizimit kundër kancerit të gjirit është realizuar një ligjerat për gratë dhe vajëzat e Komunës në bashkëpunim me Grupin Formal të Grave, Drejtorin për Shëndetësi, OJQ-n Hareja, në Lokalet e Qendres Hareja.

Zyrtrarja për Barazi Gjinore në Komunën e Lipjanit, në bashkëpunim me shoqatën “Parajsa” ka mbështetur 60 familje, me pako ushqimore dhe higjienike. Në bashkëpunim me Youth Center Lipjan ka organizuar tryezë diskutimi me temë “Mobilizimi rinor për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm”, në kuadër të projektit -Roli i institucioneve Lokale në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit tek të rinjtë.

Janë mbajtur takime me Qendrën për Punë Social rreth aktiviteteve që kanë të bëjnë me vetëdijësimin, parandalimin e dhunës në Familje dhe ofrimin e shërbimit dhe strehimit për viktimat. ZBGJ ka mbajtur ligjerata me nxënës në shtatë shkolla të komunës së Lipjanit, për parandalimin e dhunës në Familje, në financim të OSBE. Po ashtu janë mbajtur ligjerata me nxënës edhe për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore.

Ndërsa në kuadër të fushatës së 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, janë mbajtur takime me qëllim të vetëdijësimit për të drejtën e gruas në prone. Ku edhe është bërë shfaqja e filmit “ Nuk është prona jote” .



Aktivitet i realizuar nga Komuna e Lipjanit

Zyrtari për Barazi Gjinore në Komunën e Hanit të Elezit, gjatë vitit 2019 ka zhvilluar takime dhe bashkëpunime me institucionet relevante siç janë: Agjencioni për Barazi Gjinore, OSBE, Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës, Gratë Asambleiste të kuvendit të komunës së Hanit të Elezit, Gratë deputete të Kuvendit të Kosovës, KVRL, Institucionet arsimore, OJQ etj.

Zhvillimi i programeve dhe planit të punës në kuadër të aktiviteteve të ZBGJ-sëka bërë që të sigurohet se një pjesë e mirë e kuadrove komunale mund të jenë pjesë aktive e aktiviteteve të kësaj zyre, duke përfshirë instancat e kuvendit konunal por edhe ato të policisë si dhe orgnaizatit joqeveritare të cilat në këtë kohë janë identifikuar dhe janë mobilizuar për bashkëpunim. Vlen të theksohet se bashkëpunimi me Drejtorinë Komunale për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtorinë e Bujqësisë ka ndikuar në hapjen dhe rigjenerimin e vendeve të punës për gjininë femërore duke pasur parasysh që çdo përzgjedhje e përfituesve të granteve dhe përkrahje të hapje të biznesit të jenë të përfshira edhe përfitueset të gjinisë femërore, gjithashtu është punuar në sensibilizimin e familjeve me qëllim regjistrimin e pronave në emër të dy bashkëshortëve. Gjatë këtij viti janë realizuar disa aktivitete dhe bashkëpunime me OJQ- në mbajtjen e tryezave, shpërndarjen e fletëpalosjeve me qëllim sensibilizimin e qytetarëve në zbatimin e ligjit për barazi gjinore, e në fokus ka qenë regjistrimi i pronave në emër të dy bashkëshortëve, gjithashtu është shënuar 16 Ditë e Aktivizëm kundër dhunës në familje ku janë mbajtur 4 katër ligjerata me nxënës të shkollave fillore të mesme të ulët dhe të mesme të lartë. Po ashtu, ka pasur një bashkëpunim të mirë me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe QKMF, ku së bashku kanë mbajtur tryezë për vetëdijesimin e grave për kancerin e gjirit, gjithashtu QKMF ka bërë vizita shtëpiake të shumta për nënat dhe fëmijët.

Drejtoritë Komunale në Hanin e Elezit në çdo veprim që kanë bërë kanë pasur synim edhe arritjen e qëllimit edhe të barazisë gjinore si p.sh. Drejtoria e Arsimit Rinisë dhe Kulturës gjatë mbajtjes së aktiviteteve ka pasur parasysh që të organizon edhe aktivitete që përfshijnë edhe grante, jo vetëm burrat, ku gjatë ndërtimit të një salle sportive është marrë parasysh që ajo të i shërbejë dy gjinive.

Komuna e Hanit të Elezit ka pasur një bashkëpunim me donatorë dhe OJQ të ndryshme, ku ka ndërtuar 5 shtëpi për familjet në nevojë dhe prej tyre dy shtëpi janë ndërtuar nëna-prind vetëushqyes.



Aktiviteti i realizuar nga Komuna e Hanit të Elezit

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prizrenit, ka realizuar aktivitete që konsistojnë në veprimet e ndërmarra përmes takimeve, trajnimeve dhe iniciativave konkrete. Si kryesuese e grupit punues të themeluar për bashkëpunim dhe realizim të projektit për të Drejtat Sociale, në bashkëpunim me organizatën Giz-So Ri, janë realizuar takime të rregullta mujore, tryeza të rrumbullakëta, kryesisht me gratë të komuniteteve Rom, Ashkali, dhe Egjiptas si dhe anëtarët e grupit për të diskutuar rreth shërbimeve që Komuna ofron në fushën e të Drejtave Sociale dhe Barazisë Gjinore.

ZBGJ ka qenë pjesë e trajnimit mbi trajtimin e grave viktime të dhunës në familje që është mbajtur nga Qendra për strehimin e grave, ku ishin prezent edhe anëtarët e Mekanizmit koordinues për mbrojtje nga dhuna në familje. Po ashtu me ftesë të OSBE ZBGJ ka marr pjesë në tryezen e organizuar me gratë e Zhupës, ku ka shpalosur punën dhe aktivitetet që ndërmerr.

Si pjesë e MKKDHf janë mbajtur disa takime për të diskutuar gjendjen aktuale të dukurisë së dhunës në familje. Është evident ekzistimi i dhunës dhe denoncimi më i madh i rasteve të dhunës, mirëpo është konstatuar se trajtimi i rasteve nga institucionet bëhet me prioritet.

Së bashku me udhëheqësen e Asamblesë së fëmijëve në kuadër të OJQ Nevo Koncepti, janë mbajtur disa takime dhe konsultime rreth përgaditjes së tryezës me temën "Trajtimin e rasteve të dhunës ndaj fëmijëve" e cila u mbajt me 25.06.2019, ku morën pjesë anëtarët e Mekanizmit Koordinues Komunal kundër Dhunës në familje, Asambleja Komunale e fëmijëve, Drejtori i Administratës, OJQ dhe media të ndryshme. Qëllimi i tryezës ishte inicimi i politikave të përshtatshme komunale dhe krijimi i kushteve të volitshme për zhvillim të shëndetshëm dhe gjithanshëm të fëmijëve në ambiente të mbrojtura dhe të sigurta. Gjitha këto të ndërlidhura me trajtimin institucional të rasteve të dhunës ndaj fëmijëve me theks të veçant tek dhuna psikologjike në shkollë dhe në familje.

Po ashtu, janë mbajtur takime të përbashkëta me Grupin Joformal të grave Asambleiste të komunës së Prizrenit me qëllim të diskutimit rreth nxitjes së angazhimit të grave në përgjithësi për çështje të ndryshme të grave dhe adresimi i tyre. Kryesisht diskutimi është përqëndruar në implementimin e Buxhetimit Gjinor në Institucionin komunal, pastaj në gjendjen e grave në biznese dhe subvencionimi i tyre, pronësia dhe nxitja e çështjeve të pranisë së grave dhe si temë e veçant kanë qenë ekzistimi dhe problemet me qerdhet publike.

Gjithashtu, gjatë vitit ka marr pjesë dhe ka prezantuar në aktivitete të ndryshme, si ligjerata tek OJQ Orkide, rekomandime rreth dhunës psikologjike në shkollë për OJQ Nevo koncepti, vizitë strehimore në Novobërd, prezantim në punëtorinë e organizuar nga NDI etj. Në bashkëpunim me Asamblenë e fëmijëve është organizuar tryezë e rrumbullakët në temën e Dhunës në familje dhe trafikimi, mbrojtja e fëmijëve. Kjo tryezë është realizuar me Mekanizmin Komunal kundër Dhunës në Familje dhe fëmijët asambleist.

Në muajin Nëntor me koordinatoren e Asamblesë komunale të fëmijëve ka filluar procedura për botimin e një kalendari vjetor me anë të punimeve të fëmijëve dhe mesazhe edukative dhe me përmbytje me ndikim gjinor, si produkt i Asamblesë së cili do të shpërdahet tek Kryetari, Drejtorët komunal, Kuvendarët e akterë tjerë të rëndësishëm për Mbrojtjen e drejtave të fëmijëve.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Pejës, ka shënuar vitin 2019 me realizimin e aktiviteteve në avancim dhe përmirësim të pozitës së gruas në shoqëri. Në Shënim të 8 Marsit Ditës Ndërkombëtare të Gruas është organizuar marsh duke kujtuar përpjekjet shumëdimensionale për liri dhe barazi, të drejtë vte, protesta të grave punëtore gjithandej botës demokrtike kundër diskriminimit gjinor, abuzimeve, të drejtave të grave emigrante dhe përpjekja për vendimmarrje. Marshi është karakterizuar me balonat e paqes që bartnin mesazhe të shumta për një botë të barabartë dhe paqësore nga shumë gra dhe vajza të cilat besojnë tek fuçia për të udhëhequr ndryshimin. Marshi ka promovuar edhe gratë ndërmarrëse duke lobuar për barazi gjinore në punësim dhe paga si dhe ka reflektuar shumë faleminderime për mësuesen me mesazhet sikur: “Ëndrra fillon me një mësuese”, si dhe “Dy janë nëpunëset e një shteti, nëna dhe mësuesja”. E veçanta e tregimit për marshin e barazisë në Pejë është mobilizimi gjithandej i grave dhe vajzave në mbështetje të kauzës për mbrojtjen e Lumbardhit duke qenë se rrjedha e Lumbardhit është vetë jeta e qytetarëve të Pejës, e ardhmja e shumë brezave të rinj dhe potenciali më i pasur i zhvillimit ekonomik dhe turizmit në miqësi me natyrën. Po ashtu në bashkëpunim me OSBE është organizuar tryeze diskutimi rreth parandalimit të dhunës në veçanti të grave me nevojat të veçanta. Janë mbajtur takime edhe me KFOR-in Italian dhe shoqërinë civile, takime me grupin punues lidhur me planin e punës për mbrojtjen e fëmijëve dhe familjës nga abuzimi, organizuar nga Save the Children dhe Syri Vision.

Fushata e 16 Ditëve të Aktivizmit u organizua me marsh në qendër të qytetit me mesazhin kundër dhunës ndaj gruas. Pas marshit u mbajt edhe një tryezë me të gjithë akterët institucional që merren me eliminimin e dhunës ndaj gruas, ku nga nxënësit u paraqiten piktura me mesazhe ndaj dhunës. Ndërsa në përmbyllje të fushatës në bashkëpunim me policinë dhe drejtorët e shkollave janë shpërndarë fletushka tek nxënësit dhe qytetarët me moton “Qetësi në Familje, qetësi në shoqëri”.



Aktiviteti i realizuar nga Komuna e Pejës

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Kamenicës, ka raportuar në bazë të aktiviteteve të planifikuara në planin e punës. Në bashkëpunim me OJQ Norma në kuadër të projektit “Vetëdijësimi dhe aktivizimi i qytetarëve në proceset vendimmarrëse” I finanzuar nga BE, është mbajtur punëtori një ditore për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe angazhimin e tyre në hartimin e politikave. Vlen të cekët se në këtë punëtori është kërkuar nga të gjithë pjesëmarrësit (anëtarët e GGK, shoqëria civile) të japin kontributin i cili mund të shërbejë në mirëqenijën e gruas në komunën e Kamenicës. Është organizuar një ekspozitë e artit figurativ me temë të veçantë mbi Arsimimin dhe Profesionalizmin e Femrës në Komunën e Kamenicës. ZBGJ së bashku me QPS kanë përzgjedhur pesë nëna kryefamiljare për ofrimin e nihmës me pako ushqimore. Këshilli lokal i veprimit Rinor së bashku me ZBGJ dhe GGK kanë vendosur poster në rrugët e Kamenicës, me mesazh rreth ngritjes së vetëdijësimit për barazi gjinore. ZBGJ së bashku me përfaqësues të komunës, kanë pritur në takim përfaqësues të Akademisë Politike të Grave dhe përfaqësues të NDI. Qëllimi kryesor i këtij takimi ka qenë krijimi i mekanizmit koordinues për mbështetjen institucionale për strehimoren, viktimat e dhunës në familje në Novobërdë. Ofrim dhe mbështetje grave nga komuniteti Serb-Boshnjak si dhe t’i fuqizojë gratë dhe të rrisë pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. Vlen të cekët se Akademia Politike e Grave (APG) është program i Institutit Kombëtar Demokratik (IKD), është i mbështetur nga Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Për shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas, Komuna e Kamenicës i është bashkangjitur kampanjës globale botërore “16 Ditë e Aktivizimit të Dhunës Ndaj Gruas”. Komuna e Kamenicës, ZBGJ dhe GGK kanë vizituar stacionin policor në Kamenicë.

Po ashtu, ZBGJ ka organizuar takime me gra në shkollat fillore të fshatit Karaçevë të Poshtme dhe të Epërme në Roganë dhe Kamenicë, ku ka bërë prezantim rreth statistikave për tri vitet e fundit të dhunës në Kamenicë.

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Obiliqit, ka realizuar aktivitete në përmbushje të objektivave dhe planit të punës. Në kuadër të debateve me qytetarë për hartimin e strategjisë kapitale 2019-2022, me mbështetje të USAID janë organizuar debate me gratë e të gjitha OJQ-ve lokale dhe gra te lokaliteteve te ndryshme. Në këtë takim kanë marrë pjesë 70 gra dhe 5 burra. Në bashkëpunim me kordinatorën e KKSB-së, janë organizur takim me gratë e viseve rurale, me temë "Paqja dhe Siguria e Gruas në Shoqëri" projekt i cili ka zgjat 3 muaj dhe është mbështet nga IOM, ku kanë marrë pjesë 60 gra dhe 3 burra. Me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Gruas është organizuar seancë solemne. Në bashkëpunim me OSBE është organizuar tryezë mes komunës Obiliq dhe Lipjan për promovimin e Barazisë Gjinore në nivel lokal. Janë mbajtur takime të rregullta me Mekanizmin Koordinues për Mbrojtje nga Dhuna në Familje rreth trajtimit të rasteve të dhunës në Familje. Takim me një grup të nënave vetëushqyese, takimi kishte për qëllim që të njoftohemi lidhur me brengat dhe nevojat e tyre të përditshme.

Në bashkëpunim me KDI janë organizuar takim me gratë e viseve rurale, ky projekt kishte për qëllim që ti identifikohen problemet dhe nevojat e përditshme në Komunitet. Vendi ku janë mbajtur takime Mazgit i Ultë, Mazgit ilartë, Milloshevë, Raskovë, Bakshi, Sibofc, Dardhishtë, Breznicë, Kozaric, me një pjesëmarrje prej 280 gra.

Po ashtu, janë mbajtur takime me përfaqësues të KFOR-it, me organizatën Ballkan Sunfloëers, tryezë diskutimi me grupin e grave OJQ-në Qendrën Rinore, me temën "Përfshirja e grave në këshillat e fshatrave", tryezë diskutimi dy ditore me anëtarët e Grupit të Grave për hartimin e planit të vepërimit të Grupit të Grave për vitin 2020, në mbështetje të OSBE, takime me vajzat e komunitetit rom, takime me USAID dhe Grupin e Grave Asambleiste.

Në kuadër të shënimit të 16 Ditëve të Aktivizmit në mbështetje të OSBE u mbajtën ligjerata me nxënësit e dy shkollave të mesme në Obiliq me moton "Respektoje Familjen për t'u respektuar", ku moren pjesë 45 vajza dhe 25 djem. Gjatë vitit ZBGJ ka monitoruar seancat e kuvendit, komitetet për financa si dhe për komunitete. Sa i përket rasteve të dhunës në Familje në komunën e Obiliqit janë 12 gra dhe 4 burra.



Aktivitet i realizuar nga Komuna e Obiliqit

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Gjilanit, bazuar në detyrat dhe përgjegjësit që ka, si dhe konform kërkesave të dala nga Komuna ka realizuar disa aktivitete gjatë vitit 2019. Si anëtare e grupin punues të projektit SoR të mbështetur nga Giz “Shërbimet sociale për grupet vunerabël” ka marrë pjesë në punëtorinë dy ditore në qytetin e Vlorës. Përmes këtij projekti është synuar që të arrihet ngritja e vetëdijes së qytetarëve për përfitimin e shërbimeve sociale nga komuna në njërën anë si dhe ngritjes së bashkëpunimit të zyrtarëve komunal në adresimin e problematikave që kanë të bëjnë me grupet e cenueshme. Në kuadër të projektit janë trajtuar edhe familjet të cilat kanë nevojë për shërbime sociale, aty ku gratë janë nëna vetëushqyese, ku pas realizimit të vizitave në terren është arritur që të identifikohen dhe t’u mundësohet 5 familjeve pagesën e qirasë për vitin 2019 që gratë janë kryefamiljare dhe që kanë kushte të vështira ekonomike, si dhe është mundësuar ndjekja e kursit për kuzhinierë në QAP.

Shënimin e 8 Marsit ZBGJ e ka mbajtur me vizitë Policisë së Kosovës, në bashkëpunim me kryesuesen e kuvendit komuna, drejtoreshen e kulturës si dhe me stafin e kuvendit komunal. Vizita u realizua me qëllim të njoftimit rreth kushteve dhe rolit të gruas në këtë institucion.

Po ashtu u mbajtur edhe një tryezë diskutimi me temë “Rëndësia e aktivizmit të gruas në shoqëri”. Tryeza kishte si qëllim që përmes grave aktive të komunës që ishin prezent të vihet në fokus rëndësia e aktivizmit të gruas në shoqëri në të gjitha sferat, për një fuqizim të gruas në përgjithësi përmes akterëve të cilët ofrojnë mbështetje dhe punojnë për avancimin dhe fuqizimin e grave si parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm të Barazisë Gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në veçanti.

ZBGJ ka realizuar vizitë në strehimoren për mbrojtjen e gruas dhe fëmijës “Liria” për të parë nga afër kushtet që ofron kjo qendër si dhe shërbimet që i ofrohen grave dhe fëmijëve të strehuar aty.

Në bashkëpunim me Komisionin për themelimin e këshillave lokalë, janë organizuar takime konsultative me këshilltarët komunale gra, Komitetin për Barazi Gjinore dhe gratë aktive të komunës me qëllim që të lobohet dhe njëherit të kërkohet që këshillat lokalë të kenë përbërje gjinore 50%-50% në mënyrë që të zbatohen ligjet dhe rregullorja komunale për themelimin e këshillave lokalë.

ZBGJ në bashkëpunim me Drejtorinë për Financa, Kryesuesen e Kuvendit dhe Komitetin për Barazi Gjinore, kanë organizuar dëgjimin buxhetor 2020 dhe parashikimet e hershme 2021 duke i ftuar në takim gratë, rininë dhe komunitetet që të marrin pjesë dhe të japin propozimet dhe kërkesat e tyre që të përfshihen në planifikim të buxhetit dhe ta ndihmojnë komunën për ta projektuar buxhetin në mënyrën më të mirë.

Në kuadër të fushatës së 16 Ditëve të Aktivizmit, ka përgatitur disa materiale promovuese si Pano me moton “Zbatimi i Normave-Ndryshimi i Mendësisë”, fletushka dhe maica me mesazhe kundër dhunës në familje. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe ka mbajtur ligjerata me anëtarët e MKKDHf në tri fshatra të Komunës së Gjilanit: Dobërzan, Zhegër dhe Malishevë, me temë “Roli i Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje dhe rëndësia e raportimit të rasteve të dhunës në familje”.

Gjatë periudhës 1 vjeçare janë mbajtur 5 takime të MKKDHf të cilin e koordinon ZBGJ. Në bazë të informatave të ofruara nga të gjitha institucionet vlerësohet se ka rritje të lehtë të raportimit të rasteve të dhunës në familje, si tregues i rritjes së vetëdijes së qytetarëve për raportim të dhunës.

Sa i përket përfaqësimit gjinor në institucionet publike në Komunën e Gjilanit është sic vijon: 2671 janë gjithsejtë të punësuar, prej tyre 1420 burra dhe 1251 gra.



Aktivitet i realizuar nga Komuna Gjilanit

Zyrtarja për Barazi Gjinore në Komunën e Prishtinës, në bashkëpunim me Organizatën Giz ka organizuar aktivitete të ndryshme për grupet e marginalizuara në këtë komunë duke iu përmbajtur planit të punës të paraparë për vitin 2019.

Gjatë vitit janë mbajtur takime të rregullta mujore si dhe vizita në teren rreth mbrojtës së fëmijëve nga abuzimi me substanca narkotike, fëmijët në situatë në rrugë (me theks të vecantë gratë me foshnje he persona personat me aftësi të kufizuar.

Si pjesë e MKKDHF janë mbajtur takime të rregullta, ku janë shqyrtuar rastet e dhunës në familje, trafikimi dhe ngacmimet seksuale, me një përfaqësim nga QPS, Policia e Kosovës, Mbrojtësit e viktimave, strehimoret, Clard ndihma juridike falas.

ZBGJ si kordinatore e projekti për të Drejta Sociale për grupet vulnerabël SoRi në kuadër të bashkëpunimit me GIZ kanë takime me përfaqësues nga Shqipëria (Kukës, Elbasan dhe Librazhd) për të ndarë eksperiencat lidhur me zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në kuadër të projektit, "Monitorimi dhe promovimi i shpërndarjes së barabartë të të drejtave sociale për grupet në nevojë në nivel kombëtar dhe lokal .

Në bashkëpunim me organizatën INPO dhe mbështetje nga organizata gjermane GIZ në Teatrin Dodona, Prishtinë janë prezantuar dy shfaqje të titulluara, "Çantat e zbrazëta" dhe "Zëri Im" .. Nëpërmjet shfaqjes teatrale është përcjell mesazh ndërgjegjësues tek të rinjtë në respektimin e të drejtave të secilit për një jetë më të mirë dhe për të drejtën për arsim dhe edukim pa qenë të diskriminuar dhe të paragjykuar në shoqëri për shkak të gjendjes së tyre ekonomike , materiale, gjinore etj.

Në bashkëpunim me Komitetin Konsultativ për persona me aftësi të kufizuar janë organizuar takime të përbashkëta me Komitetin Konsultativ nga Komuna e Kaçanikut.

Qëllimi i këtij takimi ishte shkëmbimi i eksperiencave mes dy komunave dhe mundësit e bashkëpunimit në të ardhmen duke e pas si fokus temën "Grat me aftësi të kufizuar" si dhe "Ndal Trafikimin me Qenien Njerëzore"

Me rastin e hapjes së Fushatës Kundër trafikimit me qenien njerëzore, në bashkëpunim me Drejtorin e Arsimit është organizuar fushatë vetëdijësuese nga 18 tetor- 17 nëntor 2019, në të gjithë shkollave e Komunës së Prishtinës për ti informuar nxënësit për këtë dukuri negative mbi rreziqet nga trafikimi me njerëz dhe pjesëmarrja aktive e të gjithëve në parandalim dhe luftim të kësaj dukurie të arrijmë një efekt afatgjatë në vetëdijësimin dhe sensibilizimin e opinionit dhe referimi i rasteve.

Në kuadër të organizmit të fushatës "16 Ditët e Aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas" (simboli i kordeles së bardhe), në bashkëpunim me Policin e Kosovës janë mbajtur ligjërata informuese në shkollat e mesme të larta të Komunës së Prishtinës dhe në fund edhe një takim të përbashkët me Grupin komunal Koordinuese kundër dhunës në familje.

Ky aktivitet i fokusuar te gjeneratat e reja kishte si qëllim: Të rritet vetëdija mbi padrejtësitë ndaj femrave në shoqëri, Rritjes së informacionit, Krijimit të lidhjeve midis institucioneve, Vetëdijësimi i të rinjve për pasojat e dhunës, Inkurajimin e tyre për të lajmëruar dhunën, Parandalimi, zbutja e kësaj dukurie, Të fitojë njohuri lidhur me të drejtat e njeriut



Aktivitet i realizuar nga Komuna e Prishinës

Mandati i Agjencisë për Barazi Gjinore,

Mandati, detyrat, dhe përgjegjësitë e Agjencisë për Barazi Gjinore janë të percaktuara në Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore. Agjencia për Barazi Gjinore është organ i rëndësishëm për funksionimin e institucioneve demokratike dhe ka mandat të hartojë, të zbatojë, të propozojë, të koordinojë dhe të monitorojë politika publike vendore dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe është përgjegjëse për promovimin, mbrojtjen dhe avancimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, në Kosovë

Adresa: Agjencia për Barazi Gjinore/ Zyra e Kryeministrit,

Sheshi Skënderbe kati VII, Prishtinë, 10000

Tel: +381 38 200 14 276 Email: info.abgj@rks-gov.net

Vizitoni web faqen e ABGJ-së <http://abgj.rks-gov.net>

